



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE

#### VLORË

Nr. 901. Akti

Nr. 781. Vendimi

Date 10.04.2019. Regjistrimi

Dt. 27.06.2019

#### VENDIM

#### “NE EMER TE REPUBLIKES “

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlorë e përbërë nga :

#### GJYQTAR - Astrit SHEMA

Asistuar nga sekretare e séances Anila Rista, sot me date 27.06.2019, mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore publike ceshtjen administrative me Nr.901.akti dt. 10.04.2019, regjistrimi qe i përket paleve ndergjyqese :

**PADITËSE:** Shoqëria "Letho Resources Corp.", shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe regjistruar sipas ligjeve të Kanadasë, me seli në Vancouver, Kanada #208 -837 W.Hastings St.Vancouver, B.C., V6C 3N6 dhe zyrë në Tiranë, në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Kulla "Samos Tower", Kati 5. Email: [info@lethoresources.com](mailto:info@lethoresources.com); Tel: (778) 945 6383, e perfaquesuar ne kete gjykim me prokure nga av. Alban Alimema, ( ne mungese ne shpallje vendimi).

**I PADITUR:** 1. ALBPETROL sh.a, Fier-Patos Km. 7 Patos / Zyra në Tiranë Sky Tower, Kati i 7-të, i perfaquesuar ne kete gjykim me autorizim me nr.4020.Prot,date 30.04.2019 te Administratorit D.Spahiu prej juristit te kesaj shoqerie z.Illir Kripa dhe z.Ylli Skenderaj.

2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e perfaquesuar ne kete gjykim me autorizim me nr.4410/2.Prot,date 26.04.2019 te Ministres znj.Belinda Balluku nga juristja znj.Etleva Malile (Ne mungese,seancat e fundit)

**PERSON I TRETE :** Shoqeria "TerraOil Swiss" sh.a ,NIPT L11725004I,Rr. "Ismail Qemali", Pallati "Fratari Construction", Ap. 8/A, Tirane, Tel. 00355 4 2274 814/Fax. 00355 4 2274 816, e perfaquesuar ligjersht nga administratori i saj z.Shefqet Dizdari dhe ky i fundit me autorizim, date 17.05.2019 prej juristes se kesaj shoqerie znj.Sidorela Kola, ( ne mungese ne shpallje vendimi).

**Me pjesemarrjen e Avokature se Shtetit Zyra Vendore Vlore, e perfaquesuar ne kete gjykim prej titullaress se ketij institucioni znj.Anila Çukani (Ne mungese,sencat e fundit)**

**OBJEKTI:** 1. Anulimin e procedurave për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve hidrokarburë për vendburimin ekzistues "Cakran-Mollaj" me shoqërinë (Ish-TransoilGroup sh.a.) "TerraOil Sviss" sh.a.

2. Njohjen e shoqërisë "Letho Resources Corp." si fituese dhe dhënien e së drejtës për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjes hidrokarbure vendburimin ekzistues "Cakran-Mollaj".

3. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar procedurat për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimin ekzistues "Cakran-Mollaj" me shoqërinë (Ish-Transoil Group) "TerraOil Sviss" sh.a sh.a.

**BAZA LIGJORE:** -Nenet 7/a, 11/1, 15/a, 17/e/dh, 28-30 të Ligjit Nr. 49/2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative".

- Ligji Nr.7746, datë 28.7.1993 " Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi) (*Ndryshuar me ligjin nr. 7853, datë 29.7.1994, me ligjin nr. 8297, datë 4.3.1998, me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009, me akt normativ KM 2, datë 16.6.2010, me ligjin nr. 31/2012, datë 21.3.2015, me ligjin nr. 19/2015, datë 12.3.2015 dhe me ligjin nr. 6/2017, datë 2.2.2017*)."

-Rregullorja "Për Procedurat e Miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse", miratuar me Urdhër të Ministrit të Enerjisë dhe Industrisë nr. 246, datë 12.03.2018.

Gjykata,pasi mori provat e nevojeshme, degjoi palen inicues te ketij gjykimi e perfaqesuar nga ana e av. Alban Alimema, i cili ne kerkimin e tij perfundimtar u shpreh : Per pranimin e padise sipas objektit te saj; Paña e paditur : ALBPETROL sh.a ,nepermjet perfaqesuesit te saj ne seancen pjesemarrese ka kerkuar : rrezimin e kerkese-padise; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nepermjet perfaqesuesesse saj juristes Etleva Malile ne seancen pjesemarrese,por edhe ne pretendimet perfundimtare te derguara me shkrim ne dobi te ketij gjykimi ka kerkuar : rrezimin e padise;personin e trete Shoqeria "TerraOil Sviss" sh.a,nepermjet te autorizuares se saj ne seancen pjesemarrese u shpreh : Per rrezimin e padise; perfaqesuesja e Avokature se Shtetit Zyra Vendore Vlore nepermjet perfaqesueses se saj av.Anila Çukani ka kerkuar : Rrezimin e kerkese-padise;si e analizoi çështjen ne teresine e saj

#### **V E R E N :**

Paditesi i eshte drejtuar Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore me kerkesen object gjykimi.

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, gjykata mori ne shqyrtim dhe analizoi fillimisht juridikcionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështje.

Ne lidhje me kete fakt gjykata ju referua ligjit me nr.49/2012 ""Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative "KREUT III te saj ( nenit 7,pika b) e saj)/**kompetencia lendore**/ ne te cilin midis te tjerash citohet se :

Gjykatat administrative jane kompetente per :....

b) mosmarrëveshet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik;

Neni 16 i Ligjit Nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar ("Ligji 49/2012"), parashikon se:

"/. Padia ndaj veprimit administrativ mund te ngrihet vetem pas shterimit te ankimit administrativ.  
2. Prijashtohen nga ky rreull rastet kur:

a) ligji nuk parashikon organ me te larte per paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi me i larte administrativ nuk eshte konstituuar;

b) ligji parashikon shprehimisht te drejten per t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtperdrejt ne gjykate:

c) organi me i larte ne shqyrtimin e nje ankimi administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, te drejtat apo internal personale te ligjshem te njepersoni, i cili nuk ka qene pale ne procedimin administrative .

Ne drejtim te **kompetences tokesore** gjykata j'u referuar nenit 11 te ligjit te mesipercituar ne te cilin citohet se :

Neni 11/1 citon se : "1. Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtoher. Në rastet kur organi administrativ më i lartë, pas ankimit administrativ, e ndryshon aktin administrativ të organit vartës, padja ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendrën organi administrativ më i lartë".

Neni 11/3 e tij ku citohet se :"

3. Paditë për mosmarrëveshjet administrative, që kanë për objekt mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm, që rrjedhin nga sendet e paluajtshme, shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin në të cilin ndodhet sendi ose pjesa më e madhe e tij.

Neni 5 ku citohet se :" Kur kompetenca tokësore nuk mund të përcaktohet në këtë mënyrë, atëherë kompetente është gjykata, në territorin e së cilës ka qendrën organi publik i paditur".

Nisur persa me sipercituam gjykata vlersoi se kjo gjykata eshte kompetente nga pikepamja londere dhe tokesore ne gjykimin e kesaj kerkese.

Ne referim te nenit 12/1 te ketij ligji kjo kerkese gjykohet me nje gjyqtar.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, qyshe ne seancen pergaçitore te dates 02.05.2019, ju drejtua gjykates me nje kerkese per te mare ne shqyrtim kerkeshen e saj ne lidhje me shpalljen e moskompetences tokesore te kesaj gjykate me argumentin se nje pjesa e mire e procedurave jane kryer nga ana e Ministrise se Infrastrukturës dhe Energjisë ( si publikimi ne faqen e internetit dhe miratimi i shpalljes fitues si dhe shoqerise "Albpetrol" per fillimin e negociatave per termat dhe kushtet kryesore te Marrveshjes se Hidrokarbureve per vendburimin "Cakran-Mollaj" i eshte dhene nga kjo ministri); gjithshtu nje pjesa e mire e veprimeve administrative jane kryer ne Tirane dhe per rrjedhoje si kompetente nga pikpamja tokesore duhet te jete Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Kjo kerkese u mor ne shqyrtim nga kjo gjykate, e cila e rrezoi kete kerkim te pales se paditur Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me argumentin se e gjitha procedura administrative objekt kundershtimi prej pales paditese eshte kryer prej ALBPETROL sh.a, Patos-Fier, provuar ky fakt me gjithe provat e paraqitura nga palet e paditura ne dobi te ketij gjyktimi dhe per rrjedhoje ne referim te nenit 11/1 te ligjit me nr.49/2012"Per Gjykata Administratyive..." ku citohet se : "Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtoher.

*Në rastet kur organi administrativ më i lartë, pas ankimit administrativ, e ndryshon aktin administrativ të organit vartës, padja ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendrën organi administrativ më i lartë." gjykata çmoi se kompetente nga pikpamja tokesore eshte kjo gjykate,pasi gjithashtu nuk provohet se ndodhemi ne kushtet e pikes 2 te dispozites se mesipercuruar.*

Njekohesht,gjykata mori ne shqyrtim edhe kerkimin e po kesaj pale per te thirur ne dobi te ketij gjykim me cilesine e personit te trete dhe Shoqeria "TerraOil Swiss" sh.a,pasi kjo eshte shoqeria per te cilen nga ana e grupit te punes se ngritur prane pales e paditur prane ALBPETROL sh.a, Patos-Fier,i eshte percjelle Ministrit e gjithe praktika e ndiekur ne lidhje me shqyrtimin e ofertave te aplikuesve..."ku kjo shoqeri i eshte sygjeruar Ministrit per vazhdimin e negociatave te metejshme per te lidhur Marrveshjen e Hidrokarureve per zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve ne vendburimin "Cakran -Mollaj".

Rezulton e provuar se procedurat prej pales se paditur dhe fillimin e Marrveshjes se Hidrokarbureve per vendburimin "Cakran-Mollaj" jane kryer kundrejt personit te trete me "Transoil Group" sh.a,por gjykata duke u vene ne dijeni te faktit nga perfaquesuesja e pales se trete e thirrur ne kete gjykim me kerkimin e mesiperm se ajo ka ndryshuar emeritmin e saj me ane te vendimit date 27.02.2019 nga emerimi i meparshem "Transoil Group" sh.a ne "terraoil Swiss" sh.a,provuar ky fakt me administritiminn e ekstratin historik te rregjistrat tregtar dhe te dhenat e ketij subjekti "Shoqeri aksionere" te QKR-se prane Ministrise se Finacave,ne konformitet me nenin 199 te K.Pr.Civile berre kalimin procedural te personit te trete me cilesine/emerimin e pasqyruar ne kete gjykim.

Gjykata,kryesisht,ne konformitet me nenin 79/a te K.Pr.Civile,urdheroi njoftimin e akteve Avokatures se Shtetit Zyra Vendore Vlore,e cila realizoi perfaquesimin e saj ne gjykim.

#### **Rrethanat e faktit.**

Më datë 08.03.2018 shoqëria ALBPETROL sh.a (*në zbatim të urdhërit të MIE nr. 150, datë 6.2.2018 "Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet ekzistuese "Cakran-Mollaj", dhe "Gorisht-Kocul" dhe Amonicë"*) nëpërmjet një "Ftesë për shprehje interesit" publike, ka shpallur deklarimin e vendburimeve të lira të naftës në Shqipëri që janë nën administrimin e Albpetrol dhe ka ftuar çdo palë të interesuar të aplikojë përfushat e mëposhtme të naftës pa pagesë:

- Vendburimi "Gorisht-Kocul"
- Vendburimi "Cakran-Mollaj"
- Vendburimi Amonica

Sipas këtij njoftimi/ftese, kushdo që ishte i interesuar për lidhjen e Marrëveshjes Hidrokrabure me Albpetrol SH.A. përvendburimet lartpërmendura duhet të paraqiste zyrtarisht me postë Formularin e Aplikimit dhe të gjitha dokumentet përkatëse të përcaktuara në Formularin e Aplikimit. Formulari i Aplikimit dhe dokumentet përkatëse duhet të ishin autentike dhe të nënshkruara në çdo faqe nga palët e interesuara dhe gjithashtu duhet të përmbanin vulën zyrtare të kompanisë. Formulari i Aplikimit dhe dokumentet përkatëse duhet të dorëzoheshin veçmas për secilin vendburim, në adresën e mëposhtme: Albpetrol sh.a., Rruga Kombëtare Fier-Patos, Km 7, Patos, Shqipëri.

Dorëzimi i Formularit të Aplikimit dhe çdo dokument tjetër përkatës do të konsiderohet si një shprehje zyrtare e interesit nga subjekti që aplikon.

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzoheshin zyrtarisht në Albpetrol jo më vonë se më 31 mars 2018, ora 15.00 (ora lokale). Asnjë kërkesë nuk do të pranohet pas afatit përfundimtar të përcaktuar këtu.

Sipas njoftimit, çdo palë e interesuar në marrjen e Paketës së të Dhënave teknike dhe dorëzimin e Propozimeve përfushat e naftës të sipërpermendura duhet të kalojnë nëpër procesin e mëposhtëm:

1. Hapi i parë për aplikantin eshtë që të hyjë në kontakt me përfaqësuesin e Albpetrolit z. Bardhyl Leka. Ose përmes një takimi "ballë për ballë" ose me email përmes bardhyl.leka@albpetrol.al. Në këtë moment aplikanti paraqitet me tërë procesin, duke filluar me Deklaratën e Mos-Përhapjes, e cila duhet të jetë dakordësuar dhe nënshkruar nga aplikanti për secilin Paketë të dhëna të Dhënave në dy kopje për secilën. Një kopje shkon në arkivin e Albpetrolit dhe tjetri I mbetet aplikuesit.
2. Në të njëjtën kohë aplikanti duhet të ketë këto dokumente:
  1. Autorizimi nga kompania si përfaqësues ligjor për këtë proces
  2. Një fotokopje e ID-së së përfaqësuesit
  3. Një kërkesë zyrtare nga shoqëria aplikuese. Kjo duhet të nënshkruhet dhe vuloset.
3. Aplikuesi pastaj udhëzohet dhe / ose çohet në Drejtorinë Financiare të Albpetrolit që lëshon një faturë me TVSH dhe gjithashtu udhëzon aplikantin që të bëjë pagesën për Paketat e të Dhënave nëpërmjet një prej numrave të llogarisë bankare të Albpetrol-it.
4. Pas konfirmimit të pagesës, aplikanti dorëzon kuponin në Arkivën e Albpetrol dhe më pas merr Paketën e të Dhënave për secilën fushë që përfshin:
  1. Kopje e Paketës së dhëna të Dhënave në gjuhën shqipe
  2. Kopje e Paketës së dhëna të Dhënave në gjuhën angleze
  3. Kopje elektronike të lartpërmendurave e regjistruar në një CD
5. Në fazën tjetër, në bazë të paketës së dhëna, aplikanti paraqet propozimin e tyre në një zarf të mbyllur i cili mbahet në Arkivin e Albpetrol në një vend të sigurtë. Depozitimi i propozimeve eshtë hapur deri më 31 mars 2018. Pas kësaj date të gjitha propozimet hapen në të njëjtën kohë në sytë e të gjithë anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Propozimeve.

Po ashtu, më njoftim thuhej se "...të gjitha të dhënat teknike në lidhje me ndonjë prej këtyre fushave të naftës i nënshtrohen një pagesë prej 6,500 USD (me TVSH) për çd opaketë të dhëash. Për më shumë informacion kontaktoni z. Bardhyl Leka."

Shoqëria "Letho Resources Corp." një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe regjistruar sipas ligjeve të Kanadasë, në përgjigje të "Ftesë për shprehje interesit" të Albpetrol sh.a për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet "Cakran-Mollaj" dhe "Gorisht-Kocul" dhe Amonicë, ka aplikuar sipas Formularit të Aplikimit Standart duke dorëzuar dhe gjithë dokumentacion teknik, ligjor dhe financiar të nevojshëm dhe duke kryer edhe pagesën prej 6,500 USD për Paketën e të Dhënave vetëm për vendburimin "Cakran Mollaj" ashtu si kërkohej nga Albpetrol sh.a në ftesën për aplikim.

Pas aplikimit të shoqërisë "Letho Resources Corp.", dhe vlerësimit të ofoertave sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloren "Për Procedurat e Miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse", miratuar me Urdhër të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 246, datë 12.03.2018, Albpetrol sh.a duhet të kishte shpalluar fituesin me të cilin do të fillonte negociatat për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure por zyrtarisht nuk e ka bërë një gjë të tillë. Nuk rezulton e provuar qe pala e paditur Albpetrol sh.a te kete kryer ndon je

njoftim publik zyrtar lidhur me këtë procedurë (përveç njoftimit fillestar për shprehje interes) dhe asnjë njoftim individual për palen paditese.

Në rrugë jo zyrtare, si pasojë e një procesi gjyqësorë që njëra prej shoqërive aplikuese Alcan Petroleum LTD ka inicuar në këtë gjykate, pala paditese eshte vene ne dijeni se shoqëria Albpetrol sh.a ka shpallur si fituese shoqerinë (ish- Transoil Group sh.a) aktualisht "Terraoil Swiss" sh.a dhe ka filluar negociatat me këtë shoqëri për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure sipas urdhërit nr. 435, datë 09.05.2018 të MIE-s.

Në rrithana te tilla, pala paditese, me renien ne dijeni te ketij fakti, brenda aftit kohor te parashikuar nga nen 18 i ligjit me n.49/2012 "Per Gjykatat Administrative..." i eshte drejtuar kesaj gjykate me padine objekt gjykimi, ku si pie te trete te objekt kerkimit ka patur edhe kerkimin ne lidhje me : *Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar procedurat për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimin ekzistues "Cakran-Mollaj" me shoqerinë Transoil Group sh.a*" kerkese e cila eshte marre ne shqyrtim nga kjo gjykate brenda afatit 5 ditore, sipas parashikimeve te nenit 28/3 te ligjit me nr. 49/2012 "Per Gjykatat Administrative..." ne te cilin eshte vendosur :

*Pranimin e kërkesës në lidhje me pikën e tretë të objekti te këtij gjykimi.*

-*Marrjen e masës së sigurimit te padise, duke urdhëruar: Pezullimin e procedurave për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimin ekzistues "Cakran-Mollaj" me shoqerinë "Transoil Group" sh.a...., vendim i cili i arsyetuar u eshte bere me dijeni paleve te ketij procesi.*

#### Pretendimet e pales paditese

Vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit nga Albpetrol sh.a dhe MIE është bërë në mungesë të një transparence të plotë kjo në shkelje të Regullores "Për Procedurat e Miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse" dhe neneve 42, 43, dhe 45 të KPrAdministrative.

Megjithatë, referuar akteve që janë paraqitur si provë gjatë gjykimit të zhvilluar midis shoqërisë Alcan Petroluem dhe Albpetrol sha dhe MIE, rezulton se më datë 11.04.2018 grupi u punës i ngritur nga Albpetrol sha ka marrë në shqyrtim 7 nga 9 ofertat e paraqitura dhe për secilën prej tyre ka evidentuar dokumentacionin e paraqitur dhe nëse plotësonin kapacitetet teknike dhe financiare. Kjo është pasqyruar në një procesverbal dhe i është përcjell Ministrisë e cila ka vendosur që të vazhdojë procedurat e negocimit dhe lidhjes së Marrëveshjes Hidrokarbure me shoqerinë (ish- Transoil Group AG) "Terraoil Swiss" sh.a, por pa dhënë asnjë arsyë dhe vlerësim se pse ka zgjedhur këtë shoqëri dhe jo shoqëritë e tjera që plotësonin kapacitetet teknike dhe financiare dhe mbi çfarë baze është bërë vlerësimi dhe krahasimi i ofertave.

Pra, janë të paqarta arsyet e vendimit të marrë për shpalljen si fitues të shoqërisë (ish- Transoil Group AG) "Terraoil Swiss" sh.a.

Nëse i referohemi njoftimit "Ftesë për shprehje interes" të Albpetrol sh.a dhe rregullores "Për Procedurat e Miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse" vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit do të bëhej sipas një sistemi pikëzimi bazuar në kapacitetet teknike dhe financiare dhe kushtet që do propozonte secila prej shoqërive aplikuese për marrëveshjet hidrokarbure për secilin vendburim.

Në formularin standart të aplikimit në seksionin B përcaktohen kapacitetet teknike, në seksionin C kapacitetet financiare dhe në seksionin D kushtet e marrëveshjeve hidrokabure që propozonte secila prej shoqërive. Kualifikimi dhe vlerësimi i ofertave do të bëhej së pari duke verifikuar nëse shoqërëtë plotësonin kapacitetet teknike dhe financiare të kërkuar dhe për ato shoqëri që i plotësonin zgjedhja e fituesit, normalisht, do bëhej mbi bazën e kushteve më të favorshme që secila prej tyre kishte propozuar.

Nga ana e Ministrisë dhe Albpetrol nuk është bërë një vlerësim i tillë dhe një krahasim i ofertave dhe më pas të jepeshin arsyet e përgjegjdhjes së fituesit. Kjo e bën të dyshimtë gjithë procedurën e ndjekur për vlerësimin e ofertave dhe përcaktimin e fituesit.

Së pari, nga provat e administruara rezulton se shoqëria (sih-Transoil Group AG) "TerraOil Swiss" sh.a nuk plotëson kapacitetet teknike për tu kualifikuar dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të justifikuar këto kapacitetet.

Nëse i referohemi procesverbalit të datës 11.04.2018 të mbajtur nga grupei i punës i Albpetrol sh.a, Formularëve Standard dhe dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria (ish- Transoil Group AG) "TerraOil Swiss" sh.a rezulton se kjo shoqëri ka aplikuar për të trija vendburimet dhe dokumentacioni i paraqitur përbëhet nga:

1. Formularët e Aplikimit;
2. Bilancin e tri viteve të fundit;
3. Raportet tremujore të dy viteve të fundit
4. Listën e personelit inxhinieroteknik.

Ndërkohe, dokumentacioni që kërkohej sipas Formularëve Standard të Aplikimit ishte si vijon:

1. Bilancin e tri viteve të fundit;
2. Raportet financiare gjatë tri viteve të fundit;
3. Pasqyrë e konsoliduar e fitimit dhe humbjes
4. Të dhënat për aftësitë financiare
5. Të dhëna për kapitalet e kredituara
6. Mënyra e financimit
7. Përshkrim i operacioneve të zhvillimit dhe prodhimit të hidrokabureve të kryera;
8. Përshkrim i operacioneve të zhvillimit dhe prodhimit të hidrokabureve të kryera në vende të ngjashme;
9. Kapacitetet teknike të stafit që kanë kryer dhe drejtuar punimet e mëparshme të zhvillimit dhe prodhimit.
10. Të dhëna për operatorin e ngarkuar për menaxhimin teknik të punës.

Shoqëria ( ish-Transoil Group AG) "TerraOil Swiss" sh.a nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provonte plotësimin e kapaciteteve teknike të saj dhe ato të paraqitura për justifikimin e kapaciteteve financiare janë të mangëta.

Vetëm për këtë arsyе ajo duhej skualifikuar.

Së dyti, Albpetrol dhe MIE kanë përdorur dy standarte në mënyrën e vlerësimit të plotësimit të kapaciteteve teknike dhe finanaciare. Nga njëra anë kualifikon shoqërinë ( ish-Transoil Group AG) "TerraOil Swiss" sh.a, edhe pse kjo shoqëri nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar plotësimin e kapaciteteve teknike dhe nga ana tjetër skualifikon shoqërinë Alcan Petroleum Ltd dhe shoqërinë Shandong Kerui Oilfield Service group Co.Ltd për dokumentacion të pamjaftueshëm teknik, dhe për më tepër pa dhënë asnjë arsyе. Ndërkohe që kjo shoqëri është një nga 10 kompanitë

më të mëdha në botë për kërkimin dhe zhvillimin e hidrokabureve dhe dokumentacioni i paraqitur prej saj është në volum sa i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga të gjitha shoqëritë bashkë.

Së treti, shoqëria (ish-Transoil Group AG) "TerraOil Swiss" sh.a është përgjedhur fituese edhe pse kushtet e marrëveshjeve hidrokarbure të propozuara prej saj janë më pak të favorshme se ato të propozuara nga dy shoqëritë e tjera të kualifikuara.

Grupi i punës i Albpetrol sh.a ka kualifikuar 3 nga 7 shoqëritë pjesëmarrëse, sipas të cilit, plotësonin kapacitetet teknike dhe financiare: shoqërinë (ish-Transoil Group AG) "TerraOil Swiss" sh.a, Bankers Petroleum dhe Letho Resources Corp.

Ministria ka përgjedhur si fituese shoqërinë (Transoil Group AG) "TerraOil Swiss" sh.a por pa dhënë asnjë arsyë mbi mënyrën e vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave të tyre. Siç u tha më sipër, meqënëse këto 3 shoqëri plotësonin kapacitetet teknike dhe financiare, vlerësimi i ofertave të tyre do bëhej mbi bazën e kushteve bazë të marrëveshjeve hidrokarbure që kishte propozuar secila prej tyre. Normalisht, ajo shoqëri që kishte propozuar kushtet më të favorshme do të përzgjidhej si fituese. Por nuk ka ndodhur kështu.

Nëse i referohemi kushteve që secila prej këtyre kompanive ka propozuar në seksionin D të Formularit Standard të Aplikimit nga një krahasim i thjesht rezulton se:

- Për vendburimin Cakran Mollaj, oferta e shoqërisë Letho Resources Corp., ka qenë më e mirë në të gjitha aspektet. Kjo shoqëri propozon një investim për këtë vendburim prej 4.6 milion USD, ndërkohë shoqëria (Transoil Group) "TerraOil Swiss" sh.a 3 milion USD (seksioni D, pika b.i). Produkti paraprodhimit, shoqëria Letho 71%, ndërsa "TerraOil Swiss" sh.a (Transoil) 70% (seksioni D, pika c.ii). Kostot e rikuperueshme nga shoqëria Letho janë 89.5%, ndërsa nga shoqëria (Transoil) "TerraOil Swiss" sh.a 90% (seksioni D, pika c.iii dhe c.iv. Bonuset për punonjësit nga Letho janë 85.000 USD, ndërsa nga (Transoil) "TerraOil Swiss" sh.a 50.000 USD. Po ashtu bonusi i prodhimit për Albpetrol është më i lartë ai i shoqërisë Letho krahasuar me sasinë e produktit të prodhuar.

Për rrjedhojë, oferta e shoqërisë (Transoil Group) "TerraOil Swiss" sh.a nuk duhet të ishte shpallur si oferta më e mirë nga Ministria.

Së katërti, aplikimi i shoqërisë (Transoil Group AG) "TerraOil Swiss" sh.a nuk duhet të ishte marrë fare në shqyrim pasi kjo shoqëri nuk ka paguar tarifën për paketën e të dhënave për secilin vendburim në momentin e aplikimit.

Të gjitha sa u thanë më sipër, duke filluar nga hapja e ofertave të shoqërisë (Transoil Group AG) "TerraOil Swiss" sh.a edhe pse kjo shoqëri nuk kishte paguar tarifën e paketave të të dhënave, kualifikimi i saj edhe pse nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton plotësimin e kapaciteteve teknike, skualifikimi i shoqërisë Alcan Petroleum ltd për mos paraqitje të dokumentacioni të mjaftueshëm që vërteton plotësimin e kapaciteteve teknike pa dhënë asnjë arsyë, skualifikimi i shoqërisë Shandong Kerui Oilfield Service group Co.Ltd me të njëjtën arsyë, përgjedhja e shoqërisë (Transoil Group AG) "TerraOil Swiss" sh.a si oferta më e mirë pa dhënë arsyë mbi mënyrën e vlerësimit dhe krahasimit të ofertave dhe duke qenë evidente se oferta e saj ishte më pak e favorshme në krahasim me shoqëritë e tjera të kualifikuara por edhe me vetë shoqërinë Letho Resources Corp., shtuar këtu edhe mungesën e transparencës, informimit dhe shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve, tregojnë qartë se shoqëria (Transoil Group AG) "TerraOil Swiss" sh.a është favorizuar dhe procedura e zhvilluar ka pasur si qëllim shpalljen si fitues të kësaj shoqërie.

Përveç këtyre faktorëve të sipërcituar, janë edhe një sërë faktorësh të tjera që përforcojnë bindjen tonë se fituesi ka qenë i paracaktuar. Administratori i Albpetrol sh.a Z. Kastriot Bejtaj ka qenë në konflikt të hapur interes, pasi vëllai i tij Edmond Bejtaj është drejtor i operacioneve hidrokarbure i shoqërisë (Transoil Group AG) "TerraOil Swiss" sh.a (*shih listën e personelit inxhiniero teknik të dorëzuar nga vetë shoqëria si pjesë e dokumentacionit të dorëzuar*).

Megjithatë, ne çmojmë se oferta e paraqitur nga shoqëria Letho Resources ka qenë oferta më e mirë, ndërsa shoqëria (TransoilGroup sh.a) "TerraOil Swiss" sh.a duhet të ishte skualifikuar nga kjo proedurë për mos pagesë të tarifës së aplikimit për marrjen e paketës së të dhënavë dhe mosplotësim të kapaciteteve teknike. Gjithësesi, në çdo rast oferta e tyre ka qenë shumë herë më e ulët se oferta e paraqitur nga shoqëria Letho Resources dhe për rrjetohojë duhet të ishte kjo e fundit fituesja e procedurës dhe shoqëria së cilës duhet ti jepej e drejta për të hyrë në negociata për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimin "Cakran-Mollaj".

**Se pesti,** Në kushtet e kësaj mungese transparence dhe informimi është e pamundur të vlerësohet se cilat kanë qenë kriteret që grupi i punës për vlerësimin e ofertave ka marrë në konsideratë për shpalljen e fituesit.

Po ashtu, si pasojë e kësaj mungese transparence dhe informimi shoqërive pjesëmarrëse u është mohuar e drejta për të paraqitur ankesat apo pretendimet e tyre lidhur me mos kualifikimin e tyre apo lidhur me vlerësimin e ofertave të tyre.

Ne procedurën në fjalë nuk janë përcaktuar se kush janë kriteret mbi bazën e të cilave është bërë vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit.

Nëse i referohemi njoftimit "Ftesë për shprehje interes" të Albpetrol sh.a dhe rregullores "Për Procedurat e Miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse" vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit do të bëhej sipas një sistemi pikëzimi bazuar në kapacitetet teknike dhe financiare dhe kushtet që do propozonte secila prej shoqërive aplikuese për marrëveshjet hidrokarbure për secilin vendburim.

Në formularin standart të aplikimit në *seksionin B* përcaktohen kapacitetet teknike, në *seksionin C* kapacitetet financiare dhe në *seksionin D* kushtet e marrëveshjeve hidrokabure që propozonte secila prej shoqërive. Kualifikimi dhe vlerësimi i ofertave do të bëhej së pari duke verifikuar nëse shoqëritë plotësonin kapacitetet teknike dhe financiare të kërkuar dhe për ato shoqëri që i plotësonin zgjedhja e fituesit, normalisht, duke qenë se nuk janë përcaktuar paraprakisht kriteret për shpalljen e fitues, do bëhej mbi bazën e kushteve më të favorshme që secila prej tyre kishte propozuar.

Sjellim në vëmendje të Gjykatës se ky është edhe qëndrimi që ka mbajtur në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European (GJED).

Kështu, GJED ka vlerësuar se kriteret e dhënies së kontratës përbëjnë bazën mbi të cilën autoriteti kontraktues zgjedh ofertën më të mirë për një kontratë. Këto kriterë duhet të përcaktohen dhe t'i komunikohen ofertuesve të mundshëm paraprakisht nga autoriteti kontraktues. Kriteret e dhënies së kontratës nuk duhet të janë të dëmshme për konkurrencën e drejtë. Kriteret që mund të përdoren, janë ose i) çmimi më i ulët, ose ii) oferta ekonomikisht më e favorshme, për të cilat mund të zbatohen kriterë shtesë apo të tjera. GJED gjithashtu thekson se duhet të ketë rregulla të përgjithshme në lidhje me formulimin e kriterieve specifike që mund të zbatohen kur përdoret kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme. Objektivi kryesor është të sigurojë që ushtrimi i tregtisë të mos kufizohet nga kriteret diskriminuese të dhënies së kontratës.

Kur vendosen dhe zbatohen kriteret e dhënes së kontratës, autoriteti kontraktues duhet të veprojë në përputhje me parimet e përgjithshme të prokurimit publik dhe në veçanti të sigurojë:

**Trajtimi i barabartë dhe jo diskriminim:** kriteret e dhënes së kontratës duhet të janë jo-diskriminuese dhe nuk duhet të janë të dëmshme për konkurrencën e drejtë;

Së gjashti, nga provat e administruara rezulton se shoqëria Transoil Group AG nuk plotëson kapacitetet teknike për t'u kualifikuar dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të justifikuar këto kapacitetet.

Nëse i referohemi procesverbalit të datës 11.04.2018 të mbajtur nga grupi i punës i Albpetrol sh.a, Formularëve Standard dhe dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria Transoil Group AG rezulton se kjo shoqëri ka aplikuar për të trija vendburimet dhe dokumentacioni i paraqitur përbëhet nga:

1. Formularët e Aplikimit;
2. Bilancin e tri viteve të fundit;
3. Raportet tremujore të dy viteve të fundit
4. Listën e personelit inxhiniero-teknik.

Ndërkojë, dokumentacioni që kërkohej sipas Formularëve Standard të Aplikimit ishte si vijon:

1. Bilancin e tri viteve të fundit;
2. Raportet financiare gjatë tri viteve të fundit;
3. Pasqyrë e konsoliduar e fitimit dhe humbjes
4. Të dhënat për aftësitë financiare
5. Të dhëna për kapitalet e kredituara
6. Mënyra e financimit
7. Përshkrim i operacioneve të zhvillimit dhe prodhimit të hidrokabureve të kryera;
8. Përshkrim i operacioneve të zhvillimit dhe prodhimit të hidrokabureve të kryera në vende të ngjashme;
9. Kapacitetet teknike të stafit që kanë kryer dhe drejtar punimet e niëparshme të zhvillimit dhe prodhimit.
10. Të dhëna për operatorin e ngarkuar për menaxhimin teknik të punës.

Shoqëria Transoil Group AG nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provonte plotësimin e kapaciteteve teknike të saj dhe ato të paraqitura për justifikimin e kapaciteteve financiare janë të mangëta.

Vetëm për këtë arsyе ajo duhej s'kualifikuar.

Në këto kushte, duke çmuar se dhënia e së drejtës shoqërisë (TransoilGroup ) “TerraOil Swiss” sh.a për negocimin për lidhjen e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin “Cakran-Mollaj” është bërë në kundërshtim me Rregulloren “Për Procedurat e Miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse” dhe K.Pr.Administrative, procedurat e mëtejshme për negocimin dhe lidhjen e kësaj marrëveshjeje me këtë shoqëri duhen anuluar si të paligjshme duke njohur si fituese shoqërinë “Letho Resources Corp.”, si ofertuesja më e mirë, dhe duke i dhënë asaj të drejtën për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për këto vendburime.

Për këto arsyе, i kërkojmë Gjykates:Pranimin e padisë,sipas objektit te saj.

## **Prapesimet e pales se paditur- ALBPETROL sh.a**

### **Faktet dhe rrethat e çeshtjes.**

Shoqeria Albpetrol sh.a, eshte nje shoqeri aksionare, me kapital teresisht shteteror, e cila ka si objekt te veprimtarise se saj kryerjen e operacioneve hidrokarbure, ne perputhje me ligjin nr.7746, date 28.08.1993 Per hidrokarburet (kerkimi dhe prodhimi), i ndryshuar. Me urdherin e Ministrise se Infrastruktureve dhe Energjise (Ministri) nr.150, date 6.2.2018 "Per fillimin e procedurave per lidhjen e marreveshjeve hidrokarbure per vendburimet ekzistuese "Cakran Mollaj", "Gorisht-Kocul" dhe "Amonice", eshte urdheruar Albpetrol sh.a te njoftoje subjektet e interesuara per te marre pjese nepermjet aplikimeve per te lidhur marreveshje hidrokarbure per keto vendburime.

Ne zbatim te ketij urdheri, Albpetrol sh.a ka publikuar harten e ketyre vendburimeve si dhe formularet e aplikimit, duke percaktuar vleren e paketes per nje vendburim lie shumen 6500 (gjashtemije e peseqind) Dollare. Afati i fundit i dorezimit te aplikimeve ishte data 31.3.2018 Pas perfundimit te ketij afati, ka rezultuar se jane 9 kompani te cilat kane paraqitur dosje aplikim, midis tyre edhe shoqeria Letho Resorce corp.

Me urdherin e Administratorit te shoqerise nr.25, date 5.04.2018, eshte ngritur grupei i punes per vleresimin e ketyre aplikimeve bazuar ne kapacitetin teknik dhe finanziar te secilit aplikues. Duke qene se nga 9 subjekte aplikuese, vetem 7 kishin paguar paketen per marrjen e te dhenave, grupei i punes morri ne shqyrtim dokumentacion e paraqitur nga keto subjekte/ Ne perfundim te procesit te vleresimit te aplikimeve, grupei i punes vleresoj se ishin 3 kompani te diet i pjotesojne kriteret bazuar ne kapacitetet teknike dhe financiare, konkretish shoqerite Bankers Petroleum ltd, Transoil Group sh.a dhe Letho Resorce corp.

Ne zbatim te "Rregullores per percaktimin e procedurave te miratimit te marreveshjes hidrokarbure, license marreveshjes dhe afateve perkatese", te miratuar me Urdherin e Ministrit nr.246, date 12.03.2018, mbi bazen e vleresimit te kryer nga grupei i punes, Ministria perzgjodhi subjektin fitues, i cili ishte shoqeria Transoil Group sh.a, me te cilin nisen negociatat dhe ,u nenshkruan Termat dhe Kushtet kryesore te Marreveshjes Hidrokarbure.

Me Urdherin e Ministrit te Infrastruktureve dhe Energjise nr.435, date 09.05.2018 eshte ngritur grupei negociator per lidhjen e Marreveshjeve Hidrokarbure per vendburimet Cakran-Mollaj, Gorisht-Kocul dhe Amonice, me shoqerine Transoil Group sh.a.

Grupei negociator ka nisur negociatat per termat dhe kushtet kryesore te Marreveshjeve Hidrokarbure, me subjektin fitues, ne baze te aplikimit te paraqitur nga kjo shoqeri. Ne zbatim te "Rregullores per percaktimin- e procedurave te miratimit te marreveshjes hidrokarbure, license marreveshjes dhe afateve perkatese", grupei negociator pasi ka nenshkruar keto terma, ia ka percjelle Ministrise, e cila i ka miratuar me shkresen nr.8327/l.,date 19.06. 2018 duke kerkuarfillimin e negocimit te teksteve te Marreveshjeve Hidrokarbure.

Nderkohe negociatat per lidhjen e ketyre marreveshje hidrokarbure jane pezulluar pasi, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore me vendimin nr.162, date 08.08.2018, mbi bazen e kerkeses se shoqerise Alcan Petroleum ltd, ka vendosur:*Marrjen e mases se sigurimit te padise, duke pezulluar procedurat per negocimin dhe lidhjen e marreveshjeve hidrokarbure per vendburimet ekzistuese Cakran Mollaj, Gorisht Kocul dhe Amonice, me shoqerine Trans Oil Group sh.a.*

Nderkohe, ne date 11.04.2019, ne Gjykaten Administrative te Apelit Tirane, eshte zhvilluar seanca gjyquesore per shqyrtimin e ankimit te paraqitur nga Albpetrol kunder vendimit te mesiperme, dhe ne perfundim te shqyrtimit gjyquesor, Gjykata e Apelit, vendosi: Pranimin pjeserisht te ankimit,

duke rrezzuar kerkesen e shoqerise Alcan per sigurimin e mases se padise per vendburimin Cakran Mollaj. . Lenin ne fuqi te vendimit per sigurimin e padise per vendburimet Gorisht Kocul dhe Amonice.

#### Arsyetimi ligjor dhe analiza e fakteve

1.Kjo gjykat nuk eshte kompetente nga pikpamja tokesore.

2.Pala paditese nuk ka shteruar ankimin administrativ dhe vleresojme se pala paditese e ka ngritur kete padi jashtë afatit 45 ditor te parashikuar ne nenin 18 te ligjit me nr.49/2012...

3.Ne lidhje me pretendimin se, Albpetrol duhet te shpallo fitues paditesin Letho Resorce Corp, ky pretendim eshte teresisht i pabazuar pasi, bazuar ne "Rregulloren per percaktimin e procedurave te miratimit te marreveshjes hidrokarbure, license marreveshjes dhe afateve perkatese", e cila eshte miratuar me Urdherin e Ministrit nr.246, date 12.03.2018.

Albpetrol ka kryer proceduren e vleresimit te apikimeve, dhe ka percaktuar shoqerite te cilat plotesojne kapacitetet teknike dhe financiare, nje nga keto subjete te cilat i plotesojne keto kriteri ishte edhe paditese.

Albpetrol referuar Rregullores se mesiperme nuk ka kompetencia te perzgjecfhe shoqerine fituese, pasi kete te drejte e ka Ministria, dhe me subjektin e perzgjedhur nga kjo e fundit fillojne negociatat per Termat dhe Kushtet Kryesore te Marreveshjes Hidrokarbure. Veprimet e Albpetrolit kane qene ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe ne zbatim te urdherave Ministrit i cili eshte edhe ne rolin e Asamblese se Pergjithshme.

4.Lidhur me pretendimet e paditesit se shoqeria Trasoil Group sh.a, duhet te ishte skualifikuar nga kjo procedure per mospage te tarifes per marrjen e paketes se te dhenave, ky pretendim eshte teresisht i pabazuar.

Ne fakt rezulton se, shoqeria Transoil Group ka kryer pagesen per terheqjen e paketave per vendburimet "Cakran Mollaj", "Gorisht Kocul" dhe "Amonice", ne total ka paguar 19 500 (nentembedhjete mijë e peseqind dollar)USD, kjo eshte lethesisht e vertetueshme, pasi me shkresen nr.3091/2, date 10.04.2018 Drejtoria e Finances i ka percjell grupit te punes te ngritur per shqyrtimin e ofertave te aplikuesve informacion ne lidhje me subjektet te cilat kane bere pagesen per blerjen e paketave me te dhenat.

5. Perket pretendim se shoqeria TransOil Group sh.a nuk ploteson kapacitetet teknike per tu kualifikuar dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion per te justifikuar keto kapacitetet. Edhe ky pretendim eshte i pabazuar, pasi grupi i punes i ngritur per shqyrtimin e aplikimeve ka vleresuar 3 shoqeri te cilat permbushin kriteret e kapacitetit teknik dhe finanziar, konretisht shoqerine TranOil Group, shoqerine Bankers Petroleum dhe paditesin Letho Resorce Corp. Me dy nga keto shoqeri, Bankers dhe TransOil, Albpetrol ka lidhur marreveshje hirokarbure per kerkimin dhe zhvillimin e vendburimit te Patos-Marinzes dhe te Visokes. Pra keto jane subjekte te cilat kane nje eksperience disa vjecare ne kete fushe dhe rrejdhimisht kane kapacitetet teknike per aq kohe sa vijoje operacionet hidrokarbure ne keto vendburime.

6. Per sa i perket pretendimit se fituesi ka qene i paracaktuar, pasi ndodhemi perpara nje rasti te hapur konflikti interesit, i sjellim ne vemandje Gjykates se fituesit nuk e ka caktuar shoqeria Albpetrol, por eshte vendosur nga Ministri e Infrastrukturës dhe Enerqjise. Nga Administratori i shoqerise Albpetrol nuk ka nje vendimmarje e cila ka favorizuar subjektin e kualifikuar. Prosesi i shqyrtimit te aplikimeve eshte realizuar nga nje grup pune me perfaquesues te Albpetrolit dhe Minsitrise.

**Ka qene ky grup i cili bazuar ne kapacitetet teknike dhe financiare te aplikuesve, ka perzgjedhur 3 subjektet e kualifikuara. Ministria ka bere vleresimin e saj, duke shpallur "si fitues subjektin TransOil.**

Konkluzioni :Duke iu referuar fakteve te parashtruara me siper, provave si dhe interpretimit te ligjit, gmojme se Kerkese-padia eshte e pabazuar ne ligj dhe si e tille duhet te rrezuar.

### **Prapesimet e pales se paditur- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.**

Duke ju permblajtur kerkese-padise, fakteve, rrethanave si dhe provave te paraqitura nga palet ne gjykim vleresojme se kerkese-padia eshte e pambeshtetur ne ligj dhe ne prova dhe si e tille duhet te rrezohet per arsy se,

**Se pari:** Per sa i perket shterimit te ankimit administrativ, paditesi, shoqeria "Letho Resources Corp", nuk ka ezuaruar ankimin administrativ.

Neni 16 i Ligj it Nr. 49/2012 "*Per gjykatat administrative dhe gjykin e mosmarreveshjeve administrative*", parashikon se:

*"Padia ndaj veprimit administrativ mund te ngrihet vetem pas shterimit te ankimit administrativ".*

Pra kushti kryesor qe ligji per gjykaten administrative parashikon per tu drejtuar gjykates eshte shterimi i ankimit administrativ. Rezulton se kerkuesi ne asnjn rast nuk i eshte drejtuar zyrtarisht Albpetrolit nepermjet nje ankimi administrativ, por i drejtohet direkt gjykates nepermjet kesaj padie. Gjykata ka detyrimin te verifikoje faktin nese kerkuesi nuk ka permbushur detyrimin e parashikuar ne nenin 116 te ligjit 49/2012, pra nuk ka shteruar fazen e ankimit administrativ. Po ashtu, paditesi pretendon se i eshte drejtuar me shkresë zyrtare Ministrise, ne kete kuptim edhe ndergjyqesia eshte krijuar gabim, pasi paditesi duhet te padise Ministrine dhe padia duhet te paraqitet prane Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane.

Edhe sikur paditesi te kishte ezauruar ankimin administrativ, perseri padia e ngritur eshte jasht afatit 45 ditore te parashikuar ne nenin 18 te ligjit 49/2012, pasi sic e sqaruam edhe me lart procedura ka perfunduar qe ne maj te vitit 2018 dhe paditesi si subjekt qe ka aplikuar per kete vendburim patjeter qe ka pasur informacion ne lidhje me shpalljen fitues te kesaj procedure.

**Se dyti:** Sipas objektit te padise, paditesi kerkon anullimin e procedurave per negocimin dhe lidhjen e marreveshjeve hidrokarbure per vendburimet ekzistuese "Cakran Mollaj" dhe "Gorisht Kocul" me shoqerine Transoil Group sha;

Ne referim te nenit 17 te ligjit nr. 49/2012 "*Per funksionimin e gjykatave Administrative*", parashikohet se: **1. Padia ngrihet:** a) *per shfuzqizimin teresisht apo pjeserisht te aktit administrativ;* b) *per ndryshimin, pjeserisht apo teresisht, te aktit administrativ apo detyrimin e organit publik per te ndryshuar nje akt administrativ; c) per konstatimin e pavlefshmerise absolute te aktit administrativ; q) per te detyruar organin publik te kryeje nje veprim administrativ, qe eshte refuzuar, apo per te cilin organi publik ka heshtur, ndonese ka pasur kerkese; d) per konstatimin e paligjshmerise se veprimit administrativ, qe nuk prodhon pasoja juridike, nese paditesi ka nje interes te arsyeshem per kete; dh) per saktesimin e te drejtave dhe te detyrimeve ndermjet paditesit dhe organit publik; e) per detyrimin e organit publik per te kryer apo per te ndaluar kryerjen e nje veprimi tjeter administrativ, te nevojshem per mbrojtjen e te drejtave apo te interesave te paditesit;*

e) per percaktimin e organit qe ka ne kompetencen e tij zgjidhjen e ceshjes konkrete, duke urdheruar kur eshte rasti dhe shfuqizimin e aktit te nxjerre nga organi jokompetent; f) per shperblimin e demit jashiekontraktor, sipas ligjit te posaqem; g) per zgjidhjen e mosmarreveshjeve te punes, kur punedhenesi eshte nje organ i administrates publike. 2. Gjykata zgjidh mosmarreveshjet ne perputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera ne fuqi, qe jane te detyrueshme. Ajo ben nje cilesim te sakte te fakteve dhe veprimeve qe lidhen me mosmarreveshjen, pa u lidhur me percaktimin qe mund te propozojne palet.

Gjithashtu, edhe sipas Nenit 40 te ligjit 49/2012 te Gjykata Administrative, anullimi nuk parashikohet si obssion vendmarije e gjykates. "Vendimetperfundimtare I. Gjykata, ne vendimin e saj perfundimtar te pranimit, teresish ose pjeserisht te padise, vendos: a) shfuqizimin teresisht apo pjeserisht te aktit administrativ; b) ndryshimin, pjeserisht apo teresisht, te aktit administrativ ose detyrimin e organit publik per te ndryshuar nje akt administrativ; c) konstatimin e pavlefshmerise absolute te aktit administrativ; q) detyrimin e organit publik per te kryer nje veprim administrativ, qe eshte refuzuar, apo per te cilin organi publik ka heshtur, ndonese ka pasur kerkes; d) konstatimin e paligjshmerise se veprimit administrativ qe nuk prodhon me pasoja juridike, nese paditesi ka nje interes te arsyeshem per kete; dh) sakteimin e te drejtave dhe te detyrimeve ndermjet paditesit dhe organit publik; e) detyrimin e organit publik per te kryer apo per te ndaluar kryerjen e nje veprimi tjeter administrativ, te nevojshem per mbrojtjen e te drejtave apo te interesave te paditesit; e) percaktimin e organit qe ka ne kompetencen e tij zgjidhjen e geshtjes konkrete, duke urdheruar, kur eshte rasti, dhe shfuqizimin e aktit te nxjerre nga organi jokompetent; f) shperblimin e demit jashiekontraktor, sipas ligjit te posaqem; g) zgjidhjen e mosmarreveshjeve te punes, kur punedhenesi eshte nje organ i administrates publike. Pra ligji per gjykatat administrative nuk parashikon anullimin e nje akti administrativ. Sipas nenit 113 te Kodit te Procedures Administrative parashikohet se: "Nje akt administrativ mund te anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik qe ka kompetence te nxjerre aktin, nga organi i tij epror apo nga nje organ tjeter i parashikuar shprehimisht me ligj. 2. Anulimi i nje akti administrativ ka pasoja per te shkuaren, ndersa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetem per te ardhmen. Anulimi dhe shfuqizimi mund te jene te pjesshem apo te teresishem. 3. Anulimi ose shfuqizimi behen me nje akt te ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo ploteson aktin e pare.

Ndersa meni 114 i Kodit te Procedurave Administrative parashikon se: "Me perjashtim te rasteve te parashikuara ne nenin 108, te ketij Kodi, nje akt administrativ i paligjshem mund te anulohet apo te shfuqizohet, me qellim rivendosjen e ligjshmerise. 2. Nese pala perfituese eshte ne mirebesim, nje akti administrativ dobiprures i paligjshem, nuk mund te anulohet, por vetem mund te shfuqizohei. 3. Pala perfituese nuk vleresohet se eshte ne mirebesim nese ka qene ne dijeni te shkageve te paligjshmerise se aktit ose nuk ka qene ne dijeni te tyre per shkak te pakujdesise se rende apo nese akti eshte nxjerre, bazuar ne informacionin materialisht te gabuar apo jo te plete te dhene, me faj,nga vete pala.

Pra, sipas ketyre parashikimeve, Kodi parashikon se normalisht anullimi i nje akti mund te behet kryesisht nga vete organi administrativ, pasi ne rast se nga ky akt ka perfituar nje pale, pra kur akti i ka dhene pasojet, gjykata vetem mund ta shfuqizoje kete akt (per te ardhmen), por jo ta anulloje. Ne rastin objekt shqyrtimi gjyqesor anullimi i kesaj procedure nuk mund te vendoset nga gjykata pasi procedura ka perfunduar dhe eshte shpallur subjekti fitues.

Se treti: Lidhur me pretendimet e paditesit se shoqeria Trasoil Group sh.a, duhet te ishte skualifikuar nga kjo procedure per mospagese te tarifes se aplikimit per marrijen e te dhenave, ky pretendim eshte i pabazuar ne prova. Ne fakt rezulton se, shoqeria Transoil Group ka kryer pagesen

per terheqjen e paketave per vendburimet "Cakran Mollaj", "Gorisht Kocul" dhe "Amonice", ne total ka paguar 19 500 (nentembedhjete mijë e peseqind dollar) USD.

Procedura e ndjekur nga Albpetrol dhe MIE ka qene ne perputhje me ligjin per hidrokarburet, aktet nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij si dhe me urdherat dhe udhezimet e Ministrise se Infrastruktureς dhe Energjise, nderkohe qe paditesi nuk ka paraqitur asnjë prove, asnjë argument ligor por vetem hamendeson se duhet te ishte shoqeria e cila duhet te shpalje fituese.

Bazuar ne sa me siper kerkojme nga Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore rrezimin e kerkese-padise si te pambeshtetur ne ligj dhe ne prova.

#### Prapesimet e pales se trete-Terra OilSWISS sh.a

Duke iu permabjtur kerkese-padise, fakteve, irrethanave si dhe provave te paraqitura nga palet ne gjykim, vleresojme se kerkese-padia eshte e pambeshtetur ne ligj dhe prova, dhe si e tille duhet te rrezohet per arsyet si me poshte:

**Pike se pari** nga permabjtja e akteve verehet se pala paditese, shoqeria "Letho Resources Corp" nuk ka permabjushur nje detyrim procedural sikunder eshte ezaurimi i ankimit administrativ. Neni 16 i Ligjit 49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykin e mosmarreveshjeve administrative i cili parashikon se: " Padia ndaj nje veprimi administrativ mund te ngrihet vetem pas shterimit te ankimit administrativ". Domethene, kushti kryesor qe ligji parashikon per t'iu drejtar Gjykates eshte shterimi i ankimit administrativ. Kjo shoqeri, siç u tha edhe gjate procesit nga pala e paditur, ne asnjë rast nuk i eshte drejtar zyrtarisht Albpetrolit nepermjet nje ankimi administrativ por i eshte drejtar direkt gjykates nepermjet kerkese-padise. Sa me siper, mbetet detyrim ligor i gjykates te verifikoje faktin nese nga pala paditese eshte permabjushur ky detyrim ligor per shterim te ezaurimit te rruges administrative. Ne baze te ligjit 49/2012, gjykata ka detyrimin ligor te verifikoje faktin nese kerkuesi nuk ka permabjushur detyrimin ligor te parashikuar ne nenin 16 te ligjit 49/2012, pra nuk ka shteruar fazen e ankimit administrativ.

**Se dyti**, edhe sikur ne menyre hipotetike, te pranojme se s'shte bere ezaurimi i ankimit ne rruge administrative, verehet se perseri padia eshte ngritur jashte afatit 45 ditor qe parashikon neni 18 i ligjit 49/2012. Keshtu, nga permabjtja e akteve, konstatohet se procedura objekt ankimi ka perfunduar ne maj te vitit 2018, nderkohe qe padia eshte ngritur me 10.04.2019. Fakti i pasjes dijeni te pales paditese eshte evident nga rrethana e aplikimit nga ana e shoqerise Letho Resources Corp. lidhur me vendburimin Cakran- Mollaj.

**Se treti**, ne themel paditesi kerkon anullimin e procedurave per negocim dhe lidhjen e marreveshjes hidrokarbure per vendburimin ekzistues "Cakran-Mollaj" dhe "Gorisht- Kocul" me shoqerine Transoilgroup Sh.a. Nder te tjera paditesi referon si shkak ligor te kesaj padie neni 17 te ligjit 49/2012 "Per funksionimin e gjykatave administrative" ne te cilin percakton: 1. Padia ngrihet a) per shfuqizimin teresisht apo pjeserisht te aktit administrativ; b) per ndryshimin pjeserisht apo teresisht te aktit administrativ apo detyrimin e organit publik per te ndryshuar nje akt administrativ; c) per konstatimin e pavlefshmerise absolute te aktit administrativ; ç) per te detyruar organin publik te kryeje nje veprim administrativ qe eshte referuar apo per te cilin organi publik ka heshtur, ndonese ka pasur kerkese; d) per konstatimin e paligjshmerise se veprimit administrativ qe nuk prodhon pasoja juridike, nese paditesi ka nje interes te arsyeshem per kete; dh) per saktesimin e te drejtave dhe detyrimeve ndermjet paditesit dhe organit publik, e) per detyrimin e organit publik per te kryer apo per te ndaluar kryerjen e nje veprimi tjeter administrativ te nevojshem per mbrojtjen e te drejtave apo interesave te paditesit, e) per percaktimin e organit qe ka ne kompetencen e tij zgjidhjen e ceshtjes konkrete, duke urdheruar, kur eshte rasti, edhe shfuqizimin e aktiti te nxjerre

nga organi jokompetent; f) per shperblimin e demit jashtekontraktor, sipas ligjt te posacem; g) per zgjidhjen e mosmarreveshjeve te punes kur punedhenesi eshte nje organ i administrates publike.

Gjykata zgjidh mosmarreveshjet ne perputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera ne fuqi, qe jane te detyrueshme. Ajo ben nje cilesim te sakte te fakteve dhe veprimeve qe lidhen me mosmarreveshjen pa u lidhur me percaktimin qe mund te propozojne palet. Nderkaq gjykata, mbi pretendimet e paleve, disponon sipas parashikim.it te nenit 40 te ligjt 49/2012 anullimi nuk parashikohet si opson vendimmarrje e gjykates "Vendimet perfimdimitare". Gjykata, ne vendimin e saj perfundimtar te pranimit pjeserisht ose teresisht te padise, vendo: a) per shfuqizimin teresisht apo pjeserisht te aktit administrativ; b) per ndryshimin pjeserisht apo teresisht te aktit administrativ apo detyrimin e organit publik per te ndryshuar nje akt administrativ; c) per konstatimin e pavlefshmerise absolute te aktit administrativ; 9) per te detyruar organin publik te kryeje nje veprim administrativ qe eshte referuar apo per te cilin organi publik ka heshtur, ndonese ka pasur kerkeset; d) per konstatimin e paligjshmerise se veprimit administrativ qe nuk prodhon pasoja juridike, nese paditesi ka nje interes te arsyeshem per kete; dh) per saktesimin e te drejtave dhe detyrimeve ndermjet paditesit dhe organit publik, e) per detyrimin e organit publik per te kryer apo per te ndaluar kryerjen e nje veprimi tjeter administrativ te nevojshem per mbrojtjen e te drejtave apo interesave te paditesit, e) per percaktimin e organit qe ka ne kompetencen e tij zgjidhjen e ceshtjes konkrete, duke urdheruar, kur eshte rasti, edhe shfuqizimin e aktiti te nxjerre nga organi jokompetent; f) per shperblimin e demit jashtekontraktor, sipas ligjt te posacem; g) per zgjidhjen e mosmarreveshjeve te punes kur punedhenesi eshte nje organ i administrates publike.

Pra nga interpretimi i ketyre dispozitave verehet se ne asnje moment gjykata, edhe ne menyre sintaksiore, nuk mund te disponoje anullimin e nje kat i administrativ. Per kete na vjen ne ndihme neni 113 te K. Pr. Administrative ku parashikohet se: "1. Nje akt administrativ mund te anullohet apo shfuqizohet kryesisht nga organi publik qe ka kompetence te nxjerre aktin, nje organ i tij epror apo nga nje organ tjeter i parashikuar shprehmisht me ligj. 2. Anullimi i nje akti administrativ ka pasoja te shkuaren, ndersa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetem per te ardhmen. Anullimi dhe shfuqizimi mund te jene te pjesshem apo teresisht. 3. Anullimi ose shfuqizimi behet me nje akt te ri me shkrim i cili anullon, shfuqizon, ndryshon apo ploteson aktin e pare."

Ndersa neni 114 i K. Pr. Administrative parashikon se: "Me perjashtim te rasteve te parashikuara ne nenin 108 te ketij kodi, nje akt administrativ i paligjshem mund te anullohet apo te shfuqizohet me qellim rivendosjen e ligjshmerise. 2. Nese pala perfituese eshte ne mirebesim, nje akt administrativ dobiprures i paligjshem nuk mund te anullohet, por vetem mund te shfuqizohet. 3. Pala perfituese nuk vleresohet se eshte me mirebesim nese ka qene ne dijeni te shkaqeve te paligjshmerise se aktit ose nuk ka qene ne dijeni te tyre per shkak te pakujdesise se rende apo nese akti eshte nxjerre bazuar ne information materialisht te gabuar apo jo te plote, te dhene me faj nga vete pala.

Pra, ne permajtje te ketyre parashikimeve te sipercuruara verehet se anullimi i nje akti eshte ekskluzivitet i organit administrativ dhe vetem ne rast se nga zbatimi i ketij akti ka ardhur pasoje juridiksoni, i kalon gjyaktes e cila mund te disponoje shfuqizimin e aktit ne te ardhmen, por jo ta anulloje ate.

Ne rastin objekt shqyrtimi gjyqesor, anullimi i kesaj procedure nuk mund te vendoset nga gjykata pasi procedura ka perfunduar dhe eshte shpallur subjekti fitues.

Se fundmi, i pabazuar mbetet pretendimi i paditesit ku arsyeton se shoqeria Transoilgroup duhej te ishte skualifikuar nga procedura per shkak te mospagesesse tarifes se aplikimit, kjo pasi nje pretendim i tille nuk ka mbeshtjetje ne asnje prove. Perkunder sa me siper vertetohet e kunderta se

shoqeria Transoilgroup ka kryer pagesen duke depozituar ne total per tre vendburimet "Cakran-Mollaj" "Gorisht- Kocul" dhe "Amonice", ne total ka paguar 19'500 \$ (pagese e cila eshte kryer me date 30.03.2018).

Ne kushtet kur vertetohet se procedura e ndjekur nga Albpetrol dhe MIE ka qene ne perputhje me ligjin 7746, date 28.07.1993 "Per hidrokarburet" i ndryshuar, si dhe aktet normative te dala ne zbatim te tij dhe se nderkohe padia e ngritur ka defekt persa i perkthet ezaurimit te rruges administrative. Kjo padi eshte ngritur jashtë afatit ligjor 45 ditore te percaktuar nga ligji dhe se ne themel kerkimet objekt padie jane te pababzuara (subjektive).

Perfundimisht, bazuar ne me siper, kerkojme nga Gjykata Administrative e Shkalles se Pare, Vlore, rrezimin e kerkese padise si te pambeshtetur ne ligj dhe ne prova.

**Qendrimi i Avokature se Shtetit Zyra Vendore Vlore** eshte i njejete me argumentat e parashtruara nga pala e paditur Ministria e Infrastrukturës dhe Enerjisë.

#### Ligji i zbatueshem

-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 42 të saj, parashikon se:

*"Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjyktimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj".*

-Ky parashikim kushtetues është në të njëjtën linjë me nenin 6 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore:

*"Çdo person ka të drejtë që cështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si përmosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e cdoakuze të natyrës penale që i është drejtuar".*

-Ndërkohë, gjykatat detyrohen edhe nga nenin 44 i Kushtetutës, sipas të cilit:

*"Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhđëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.*

-Për sa më sipër, vendimi objekt shqyrtimi do të trajtohet nga gjykata si cdo akt administrativ. Në nenin 15 te igjit me nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet, se: Te drejten e padise e ka :a) *do subject, qe pretendon se i eshte cenuar nje e drekte apo nje interes i ligjshem nga nje veprim apo mosveprim i organit public;*

*"Padia, sipas nenit 17 të këtij Ligji mund të ngrihet kur paditësi argumenton se akti administrativ është i paligjshëm dhe se atij i cënohen interesat dhe të drejtat e tij në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, individualisht ose në mënyrë kolektive...".*

-Kodi I Procedures Administrative te Republikës se Shqipërisë.

Ligji Nr.7746, datë 28.7.1993 " Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)" (Ndryshuar me ligjin nr. 7853, datë 29.7.1994, me ligjin nr. 8297, datë 4.3.1998, me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009, me akt

*normativ KM 2, datë 16.6.2010, me ligjin nr. 31/2012, datë 21.3.2015, me ligjin nr. 19/2015, datë 12.3.2015 dhe me ligjin nr. 6/2017, datë 2.2.2017).*

-"Rregullorja per percaktimin e procedurave te miratimit te marreveshjes hidrokarbure, license marreveshjes dhe afateve perkatese" e miratuar me urdherin e Ministrit te Infrastrukturae dhe Energjise nr.246, date 12.03.2018.

*Ne rast se, ka me shume se nje aplikim per nje bllok ose vendburim te lire, AKBN ose Albpetrol sipas rastit, percjellin ne Ministri dokumentacionin e shoqerive aplikuese dhe vleresimin e tyre bazuar ne kapacitetin teknik, finanziar dhe termat dhe kushtet kryesore te marreveshjes hidrokarbure. Mbi kete documentation te paraqitur Ministria ben vleresimin e saj.*

*Ne rast miratimi nga ministria te kerkeses se AKBN ose Albpetrol, me urdher te ministrit ngrihet grupei negotiator, i cili fillon negociatat me subjektin e perzgjedhur fitues nga Ministria per Termat dhe Kushtet Kryesore te Marreveshjes Hidrokarbure, ne baze te aplikimit te paraqitur nga subjekti fitues.*

### Zgjidhja ligjore

Gjykata ne lidhje me barren e proves ka per reference nenin 35 te ligjit me nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"-Bara e proves ne te cilin citohet se :"*1. Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashiruar dhe ka vënë në themel të veprimitarës së kundërshtuar në gjykatë.*

Gjykata, duke vlerësuar në tërësi rrëthanat faktike të provuara në gjykim nëpërmjet provave shkresore, thëniet dhe pohimet e palëve ndërgjyqëse, të çmuara në përputhje me nenet 10,11,12, 29, 213, 214, 246 e vijues dhe 253 e vijues të KPrC dhe mbështetjen ligjore të padisë, si dhe duke referuar në hapësirën ligjorë që krijon neni 16 i KPrC sipas të cilit "*Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen pa u lidhur me përcaktimet që mund të propozojnë palët.*", arrin në konkluzionin se padia duhet pranuar, për arsyet si më poshtë vijon:

Gjykata, fillimisht e gjen me vend te shprehet ne lidhje me pretendimin e pales se paditur dhe personit te trete ne lidhje me kompetencen tokesore te kesaj gjykate.

Kjo gjykate eshte kompetente nga pikpamja tokesore pasi e gjithe procedura administrative eshte kryer prane pales se paditur ALBPETROL sh.a, *Fier-Patos*.

Referuar nenit 11 te ligjit me nr.49/2012 "Per gjykata administrative..." kjo gjykate eshte kompetenta nga pikpamja tokesore pasi ne dispoziten e mesiperçituar parashikohet se :

### Neni 11

#### *Kompetencia tokësore*

- Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykaten administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet.*

Ne lidhje me pretendimin tjeter te pales se paditur se kjo padi duhet te rrezohet per faktin se eshte ngritur jashtë afatit 45 ditor dhe ne referim te nenit 18 te ligjit me nr. 49/2012 "Per gjykata

administrative..."gjykata arsyeton se : Padia është ngritur brenda afatit 45 ditor nga momenti që shoqëria Letho Resources Corp ka marrë dijeni për shpalljen si fitues të shoqërisë Transoil Group AG, dijeni e cila është marrë si pasojë e procesit gjyqësor që ka zhvilluar njëra prej shoqërive pjesëmarrësve (shoqëria Alcan Petroluem), pasi Albpetrol dhe MIE nuk kanë kryer asnjë njoftim zyrtar për shoqëritë pjesëmarrëse. Albpetrol dhe MIE kanë pasur barrën e provës për të provuar se kanë njoftuar shoqërinë Letho Resources Corp për veprimet administrative dhe se kjo shoqëri nuk i ka kundërshtuar ato brenda afatit ligjor.

Afati 45 ditor i ankimit fillon nga data e marrjes dijeni ne lidhje me ne lidhje me veprimin e paligjshem te aktit administrativ apo veprimit administrativ te organit publik veprim i cili ndikon d.p., drejtë mbi interesta e ligjeshme te te subjektit i cili ka qene pjesemrres ne nje procedure administrative nga e cila rrjedhin interesa te d.p., drejta te saj.

Pretendimi tjeter i pales se paditur ka qene se kjo padi nuk mundte te merret ne shqyrtim nga kjo gjykate me argumentin se shoqeria "Letho Resources Corp" nuk ka perm bushur nje detyrim procedural sikunder eshte ezaurimi i ankimit administrativ, gjykat e gjen me vend te shprehet se :

**Është tashmë praktikë e konsoliduar gjyqësore se është detyrë e gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen të kuptojë drejt natyrën e konfliktit te krijuar mes palëve, shkakun ligjor te kërkimit, përcaktimin e drejte te ligjit te zbatueshëm dhe si rezultat të zgjidhë mosmarrëveshjen objekt gjykimi ne përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej tyre.**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ka vleresuar se **shqyrtimi dhe zgjidhja e një çështjeje nga gjykata nuk mund të bazohet vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në aktet e procesit dhe që mund të emërtohen objekti apo baza ligjore.** Gjykatat gjatë shqyrtimit të çështjeve që u shtrohen për gjykim, kanë detyrimin të vlerësojnë dhe të marrin parasysh të gjithë përbajtjen e akteve procedurale, të identifikojnë shkakun ligjor të kërkimeve në mënyrë që të mund të jalin vendime të drejta për to. Sa më sipër është shprehur qartë dhe në Vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.3/2012: "Gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkësëpëdisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkësëpëdisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar".

**Do të konsiderohet rrugë e detyrueshme administrative, në ato raste kur ligji specifik parashikon në mënyrë të shprehur të gjithë elementet e domosdoshme të kësaj rruge, si paraqitja e kërkësës ankimore tek organi më i lartë dhe afati brenda se cilës ushtrohet kjo e drejtë, përcaktimi i organit më të lartë që merr në shqyrtim këtë kërkësë dhe afatin brenda të cilës ky i fundit e merr në shqyrtim atë, vendimet që merren nga organi më i lartë, e drejta e ankimit në gjykate, etj...**

Këtë qëndrim mbajnë edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin e tyre unifikues nr.1, datë 26.11.2010, ku kanë arritur në konkluzionin unifikues se: "Ndjekja e rrugës administrative (të apelimit administrativ) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përparrësë subjekti t'i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhëniet juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse, parashikon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative tek të cilët eventualisht, sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ. Përveç detyrueshmërisë se parashikimit të ndjekjes së rrugës administrative të

*ankimit, të organit ku ai drejtohet dhe që ka kompetencën për shqyrtimin e saj, eventualisht, sipas natyrës se marrëdhënieve juridike dhe asaj te mosmarrëveshjes, ligji i posaçëm mund te parashikoje ose jo edhe modalitetë konkrete mbi afatet, kushtet e procedurat që duhen respektuar për te bere te pranueshmë për shqyrtim ne themel ankimin administrativ, për procedurat e shqyrtimit dhe natyrën e vendimmarrjes nga organi administrative, etj. Nëse rregulla te tilla eventuale nuk janë parashikuar, gjunjë zbatim afatet, kushtet e procedurat e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative. Kjo mënyre e shprehjes se vullnetit te ligjvënësit, nga njëra ane autorizon dhe legjitimoni organin administrativ te pranoje, marre ne shqyrtim dhe vendose lidhur me ankimin administrativ, nga ana tjetër, jo vetëm i detyron te ndjekin rrugën administrative për efekt te respektimit te uniformitetit te veprimtarisë administrative dhe sigurisë juridike, por, mbi te gjitha, dhe i garanton individëve dhe subjekteve te tjerë një proces te rregullt ligor dhe një mjet efektiv juridik, pasi pretendimi i tyre për cenimin e një te drejte a interesit kushtetues dhe ligor detyrimisht do te merret ne shqyrtim dhe do te zgjidhet nga organi administrativ. Në çdo rast, pavarësisht nëse parashikohet apo jo shprehimisht ne ligjin e posaçëm, pas dhënies se vendimit nga organi apo organet administrative te ngarkuar nga ligji, pala qe kishte ushtruar ankimin administrativ ka te drejtën t'i drejtohet rrugës gjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative. Nëse ligji i posaçëm nuk e parashikon shprehimisht, zbatohen afatet dhe procedurat e parashikuara për ketë qellim nga Kodi i Procedures Civile dhe Kodi i Procedurave Administrative".*

Pra, pretendimi i pales se paditur dhe personit te trete se paal paditese nuk ka konsumuar rrugen e ankimit administrativ eshte e pa bazuar ne ligj dhe per rrjedhoje, ky kerkim duke u gjetur i pa bazuar, duhet te rrezohet.

Ne lidhje me zgjidhjen ne themel te pretendimin e pales paditese gjykata arsyeton persi me poshte vijon :

Nga hetimi gjyqesor i kesaj çeshtje rezultoi e provuar se : Më datë 08.03.2018 shoqëria ALBPETROL sh.a (në zbatim të urdhërit të MIE nr. 150, datë 6.2.2018 "Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet ekzistuese "Cakran-Mollaj", dhe "Gorisht-Kocul" dhe Amonicë) nëpërmjet një "Ftesë për shprehje interesit" publike, ka shpallur deklarimin e vendburimeve të lira të naftës në Shqipëri që janë nën administrimin e Albpetrol dhe ka ftuar çdo palë të interesuar të aplikojë përfushat e mëposhtme të naftës pa pagesë:

- Vendburimi "Gorisht-Kocul"
- Vendburimi "Cakran-Mollaj"
- Vendburimi Amonica

Sipas këtij njoftimi/ftese, kushdo që ishte i interesuar për lidhjen e Marrëveshjes Hidrokrabure me Albpetrol SH.A. për vendburimet lartpërmendura duhet të paraqiste zyrtarisht me postë Formularin e Aplikimit dhe të gjitha dokumentet përkatëse të përcaktuara në Formularin e Aplikimit. Formulari i Aplikimit dhe dokumentet përkatëse duhet të ishin autentike dhe të nënshkruara në çdo faqe nga palët e interesuara dhe gjithashtu duhet të përmbanin vulën zyrtare të kompanisë. Formulari i Aplikimit dhe dokumentet përkatëse duhet të dorëzoheshin veçmas për secilin vendburim, në adresën e mëposhtme: Albpetrol sh.a., Rruga Kombëtare Fier-Patos, Km 7, Patos, Shqipëri.

Dorëzimi i Formularit të Aplikimit dhe çdo dokument tjetër përkatës do të konsiderohet si një shprehje zyrtare e interesit nga subjekti që aplikon.

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzoheshin zyrtarisht në Albpetrol jo më vonë se më 31 mars 2018, ora 15.00 (ora lokale). Asnjë kërkesë nuk do të pranohet pas afatit përfundimtar të përcaktuar këtu.

Sipas njoftimit, çdo palë e interesuar në marjen e Paketës së të Dhënave teknike dhe dorëzimin e Propozimeve përfushat e naftës të sipërpërmendura duhet të kalojnë nëpër procesin e mëposhtëm:

2. Hapi i parë për aplikantin është që të hyjë në kontakt me përfaqësuesin e Albpetrolit z. Bardhyl Leka. Ose përmes një takimi "ballë për ballë" ose me email përmes bardhyl.leka@albpétrol.al. Në këtë moment aplikanti paraqitet me tërë procesin, duke filluar me Deklaratën e Mos-Pérhapjes, e cila duhet të jetë dakordësuar dhe nënshkruar nga aplikanti për secilin Paketë të të Dhënave në dy kopje për secilën. Një kopje shkon në arkivin e Albpetrolit dhe tjetri I mbetet aplikuesit.
3. Në të njëjtën kohë aplikanti duhet të ketë këto dokumente:
4. Autorizimi nga kompania si përfaqësues ligjor për këtë proces
5. Një fotokopje e ID-së së përfaqësuesit
6. Një kërkesë zyrtare nga shoqëria aplikuese. Kjo duhet të nënshkruhet dhe vuloset.
7. Aplikuesi pastaj udhëzohet dhe / ose çohet në Drejtorinë Financiare të Albpetrolit që lëshon një faturë me TVSH dhe gjithashu udhëzon aplikantin që të bëjë pagesën për Paketat e të Dhënave nëpërmjet një prej numrave të llogarisë bankare të Albpetrol-it.
8. Pas konfirmimit të pagesës, aplikanti dorëzon kuponin në Arkivën e Albpetrol dhe më pas merr Paketën e të Dhënave për secilën fushë që përfshin:
9. Kopje e Paketës së të Dhënave në gjuhën shqipe
10. Kopje e Paketës së të dhënave në gjuhën angleze
11. Kopje elektronike të lartpërmendurave e regjistruar në një CD
12. Në fazën tjetër, në bazë të paketës së të dhënave, aplikanti paraqet propozimin e tyre në një zarf të mbyllur i cili mbahet në Arkivin e Albpetrol në një vend të sigurtë. Depozitimi i propozimeve është hapur deri më 31 mars 2018. Pas kësaj date të gjitha propozimet hapen në të njëjtën kohë në sytë e të gjithë anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Propozimeve.

Po ashtu, më njoftim thuhej se "...të gjitha të dhënat teknike në lidhje me ndonjë prej këtyre fushave të naftës i nënshtrohen një pagesë prej 6,500 USD (me TVSH) për çdo paketë të dhëna. Për më shumë informacion kontaktoni z. Bardhyl Leka."

Shoqëria "Letho Resources Corp." një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe regjistruar sipas ligjeve të Kanadasë, në përgjigje të "Ftesë për shprehje interesit" të Albpetrol sh.a për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet "Cakran-Mollaj" dhe "Gorisht-Kocul" dhe Amonicë, ka aplikuar sipas Formularit të Aplikimit Standart duke dorëzuar dhe gjithë dokumentacion teknik, ligjor dhe financiar të nevojshëm dhe duke kryer edhe pagesën prej 6.500 USD për Paketën e të Dhënave vetëm për vendburimin "Cakran Mollaj" ashtu si kërkohej nga Albpetrol sh.a në ftesën për aplikim.

Pas aplikimit të shoqërisë "Letho Resources Corp.", dhe vlerësimit të ofertave sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloren "Për Procedurat e Miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse", miratuar me Urdhër të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 246, datë 12.03.2018, Albpetrol sh.a duhet të kishte shpalluar fituesin me të cilin do të fillonte negociatat për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure.

Nuk rezulton e provuar qe pala e paditur Albpetrol sh.a ta kete kryer një procedure te tille. Nuk provohet qe kundrejt pales paditese te kemi ndonje njoftim publik zyrtar lidhur me këtë procedurë (përveç njoftimit fillestari për shprehje interesit) dhe asnjë njoftim individual për kete shoqeri.

Në rrugë jo zyrtare, si pasojë e një procesi gjyqësorë që njëra prej shoqërive aplikuese Alcan Petroleum LTD ka inicuar në këtë gjykatë, pal paditese eshte vene ne dijeni se shoqeria Albpetrol sh.a ka shpallur si fituese shoqërinë ( ish- Transoil Group sh.a) aktualisht " Terraoil Swiss" sh.a dhe ka filluar negociatat me këtë shoqeri për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure sipas urdhërit nr. 435, datë 09.05.2018 të MIE-s.

Gjykata konstaton se vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit nga Albpetrol sh.a dhe MIE është bërë në mungesë të një transparence të plotë dhe ky fakt eshte në shkelje të Rregullores "Për Procedurat e Miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse" dhe neneve 42, 43, dhe 45 të KPrAdministrative.

Referuar akteve që janë paraqitur si provë gjatë gjykimit të zhvilluar midis shoqërisë Alcan Petroluem dhe Albpetrol sha dhe MIE, rezulton se më datë 11.04.2018 grupi u punës i ngritur nga Albpetrol sha ka marrë në shqyrtim 7 nga 9 ofertat e paraqitura dhe për secilën prej tyre ka evidentuar dokumentacionin e paraqitur dhe nëse plotësonin kapacitetet teknike dhe financiare. Kjo është pasqyruar në një procesverbal dhe i është përcjell Ministrisë e cila ka vendosur që të vazhdojë procedurat e negocimit dhe lidhjes së Marrëveshjes Hidrokarbure me shoqërinë ( ish- Transoil Group sh.a) aktualisht " Terraoil Swiss" sh.a ,pa dhene arsyte qarta dhe ligjore per zgjedhjen e kesaj shoqerie kundrejt pales paditese apo shoqerive te tjera pjesmerrese te cilat plotësonin kapacitetet teknike dhe financiare dhe mbi çfarë baze është bërë vlerësimi dhe krahasimi i ofertave,duke i sygjeruar Ministrit vazhdimin e negociatave te metejeshme per te lidhur marrveshjen e hidrokarbureve per zhvillimin dhe prodhimin e vendburimeve ekzistuese Gorisht-Kocul,Cakran -Mollaj dhe Amonice,duke e konsideruar kete kompani e cila vleresohet si serioze ne punimet ekryera ne Shqiperi dhe me mendimin se do te japi një kontribut ne diversifikimin e prodhimit te naftes bruto nga vendburimet ekzistuese te naftes dhe gazit.

Gjykata vlereson se vlerësimi i kritereve dhe ofertave dhe shpallja e fituesit per vendburimin Cakran -Mollaj është bërë në mungesë të një transparence nga ana e Albpetrol sh.a dhe MIE-s, në shkelje të Rregullores "Për Procedurat e Miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse" dhe të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.pasi : Se pari pas aplikimit të shoqërive të interesuara, sipas Rregullores "Për Procedurat e Miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse", miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me Urdhër nr. 246, datë 12.03.2018, Albpetrol sh.a, pasi të bënte hapjen e ofertave dhe vlerësimin e tyre bazuar në kapacitetin teknik dhe finanziar do t'i përcillte Ministrisë gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga shoqëritë aplikuese dhe më pas Ministria duhet të kishte shpalluar fituesin me të cilin do të fillonte negociatat për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure.

Nga provat e paraqitura (të cilat shoqeria Letho Resources Corp i ka siguruar jo zyrtarisht) rezulton se shoqeria Albpetrol sh.a ka mbajtur një procesverbal më datë 31.03.2018, ora 15:00 ku janë pasqyruar aplikimet e shoqërive respektive me numrin e protokollit, datën dhe orën e dorëzimit të aplikimit. Me urdhërin nr. 25, datë 05.04.2018 të Administratorit të Albpetrol sh.a është urdhëruar ngritja e grupit të punës për shqyrtimin e ofertave të aplikuesve bazuar në kapacitetet teknike dhe finanziare.

Më datë 11.04.2018, grupi i punës i ngritur me këtë urdhër ka marrë në shqyrtim 7 nga 9 aplikimet e paraqitura, duke mos marrë aplikimet e shoqërive Zenith Energy ltd dhe Pennine Petroleum Corporation pasi këto nuk kishin kryer pagesën për blerjen e paketës së të dhënave për secilin vendburim (6.500 USD/secili). Për këtë është mbajtur një procesverbal ku pasqyrohen dokumentacioni i paraqitur nga secula prej shoqërive dhe jepet një vlerësim për kapacitetin teknik dhe finanziar të secelës prej tyre. Dokumentacioni dhe vlerësimi i grupit të punës i janë përcjellë

MIE-s me shkresën nr. 3091/4 prot, datë 12.04.2018. MIE me urdhërin nr. 435, datë 09.05.2018 ka ngritur grupin negociator për fillimin e negociatave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure me shoqërinë (ish- Transoil Group sh.a) aktualisht ”TerraOil Swiss” sh.a për të trija vendburimet dhe me shkresën nr. 6251/2 prot, datë 09.05.2018 i ka kërkuar Albpetrol sh.a vazhdimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve me këtë shoqëri.

E gjitha kjo procedurë e ndjekur është s'ështe bere transparente, pasi shoqëria Letho Resources Corp, si shoqëri aplikuese por edhe si një nga 3 shoqëritë e kualifikuara që plotësonin kapacitetet teknike, nuk është informuar.

Kjo tregon qartë përmungesën e transparencës, informimit, drejtësisë dhe paanësisë, shkeljen e barazisë së pjesëmarrësve.

Procedura e ndjekur nga Albpetrol sh.a dhe MIE për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet “Cakran-Mollaj”, “Gorisht-Kocul dhe Amonicë” është një procedurë administrative për lidhjen e kontratave administrative. Marrëveshjet hidrokarbure janë kontrata administrative dhe si të tillë për lidhjen e tyre, përvëç procedurës së përcaktuar në “Për Procedurat e Miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse”, zbatohen edhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative. Kjo del qartë nga përbajtja e neneve 33 e vijues të KPrAdministrative.

Neni 33 i KPrAdministrative parashikon se: “*1. Palë në procedurën administrative, përvëç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person:...c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.*”

Më tej në nenet 42, 43 dhe 45 të KprA parashikohet se:

*Neni 42 /Komunikimi me palët*

*1. Në rastet kur procedura administrative fillohet nga organi i publik, ky i fundit njofton të gjitha palët në proces përfillimin e veprimeve...*

*3. Kur njoftimi bëhet me takim, organi publik mban procesverbal për dokumentimin e veprimit të kryer.*

*4. Organ i publik nuk është i detyruar të komunikojë me palët në rastet kur çështja është “Sekret shtetëror”, sipas klasifikimeve të bëra me ligj ose kur në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme komunikimi mund të cenojë efektivitetin e procedurës administrative.*

*Neni 43 /Njësia dhe nëpunësi përgjegjës*

*1. Në një procedurë administrative, të filluar sipas parashikimeve të nenit 41, të këtij Kodi, organi publik vepron nëpërmjet nëpunësit përgjegjës, të përcaktuar sipas rregullave të këtij neni.*

*2. Titullari i organit publik, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj ose akt nënligjor, cakton paraprakisht një njësi përgjegjëse për çdo tip procedure administrative në kompetencë të organit, në përputhje me rregullat e brendshme të veprimitarisë së tij. Ky vendim bëhet publik me çdo mjet të përshtatshëm.*

*3. Drejtuesi i njësisë përgjegjëse merr përsipër vetë ose cakton me akt të shkruar nëpunësin përgjegjës përfundim propozon me shkrim vendimin përfundimtar, ndërsa vendimi*

*merret dhe nënshkruhet nga personi i përcaktuar nga ligji ose aktet nënligjore. Nëse vendimi është i ndryshëm nga ai i propozuar, duhet të shoqërohet me arsyetimin përkatës.*

*4. Në rastet e parashikuara nga ligji nëpunësi përgjegjës, pasi zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen me vendim përfundimtar dhe e nënshkruan atë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji.*

*5. Organi kolegjal mund të ngarkojë njërin nga anëtarët e tij të zhvillojë veprime procedurale administrative. Në këtë rast, anëtari i ngarkuar vë në dijeni mbi rezultatet e procedurës administrative organin kolegjal, i cili vendos për çështjen.*

*Neni 45 /E* drejta e palëve për njohje me dosjen

*1. Të gjitha palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrin kopje të tyre.*

*2. Organi publik, i përfshirë në procedurën administrative, brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës, siguron në mjetet e tij të punës kushte për mbajtjen e të dhënavë, si dhe kushte për njohjen dhe marrjen e kopjeve të dokumenteve, sipas pikës 1 të këtij nenit. Në raste të veçanta, kur është më e përshtatshme për kërkuesin, njohja me dosjen mund të bëhet edhe në mjetet e një organi tjeter publik ose në përfaqësitetë konsullore dhe diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit.*

*3. Dokumentet që përbajnë të dhëna personale, tregtare ose profesionale, mund të merren ose të përdoren nga të tretët vetëm me pëlgimin e individit, të cilin i përkasin këto të dhëna. Pëlgimi nuk kërcohët nëse dokumentet do të përdoren për qëllime të parashikuara në ligj ose akte nënligjore.*

*4. Kur dokumentacioni administrohet në formë elektronike, organi publik i siguron palës mjetet e nevojshme teknike për njohjen me të. Organi publik mund t'i bëjë dokumentet elektronike të aksesueshme nga interneti, nëse kjo nuk cenon sigurinë e të dhënavë të mbrojtura sipas ligjit.*

*5. Lëshimi i kopjeve të dokumenteve bëhet kundrejt një pagese, që përcaktohet në vendimin e organit publik dhe në çdo rast nuk kalon koston e riprodhimit të tyre.*

Siq mund të shihet nga përbajtja e këtyre neneve, organi publik, në ato raste kur ka filluar procedurën administrative me iniciativë të vetë, ka detyrimin që të komunikoj me palët pjesëmarrësë në këtë procedurë. I vetmi rast kur ai nuk është i detyruar të komunikojë me palët është kur çështja është "Sekret shtetëror", sipas klasifikimeve të bëra me ligj ose kur në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme komunikimi mund të cenojë efektivitetin e procedurës administrative (neni 42, pika 6).

Në rastin konkret nuk jemi në asnjë prej këtyre rasteve përashtimore dhe për rrjedhojë nuk mund të pretendohet se nuk ka pasur detyrim ligor për të informuar shoqëritë pjesëmarrëse.

Po ashtu, në nenin 43 të K.Pr.Ad. parashikohet se në një procedurë administrative të filluar me iniciativë të organit publik, ai duhet të caktoj një njësi ose person perjegjës për ndjekjen e procedurës i cili ka edhe detyrimin për të komunikuar me palët. Në rastin konkret, Ministria ka autorizuar Albpetrol sha për ndjekjen e procedurave dhe kjo e fundit ka caktuar si person kontakti me shoqëritë aplikuese Z. Bardhyl Leka, i cili ka qenë i disponueshëm deri në momentin e paraqitjes së aplikimeve dhe më pas nuk ka informuar asnjë prej shoqërive.

Neni 44 parashikon madje të drejtën e palëve pjesëmarrëse në një procedurë administrative për t'u njojur me dosjet dhe për të marrë kopje të tyre, gjë e cila nuk është mundësuar nga palët e paditura gjatë procedurës administrative por vetëm gjatë gjykimit.

Për rrjedhojë, palët e paditura duke mos informuar shoqërinë Letho Resources Corp mbi procedurën e ndjekur, mënyrën e vlerësimit dhe klasifikimit të ofertave dhe kriteret që kanë marrë në konsideratë për shpalljen e fituesit jo vetëm që kanë shkelur drejtëpërdrejtë nenet 42, 43 dhe 45 të KPrAdministrative por kanë shkelur edhe parimet kryesore të zhvillimit të një procedure administrative të tilla si parimi transparencës (neni 5), parimi informimit (neni 6), parimi i drejtësisë dhe paanësisë (neni 13), parimi i barazisë (neni 17).

Në kushtet e kësaj mungese transparence dhe informimi është e pamundur të vlerësohet se cilat kanë qenë kriteret që grupi i punës për vlerësimin e ofertave ka marrë në konsideratë për shpalljen e fituesit.

Po ashtu, si pasojë e kësaj mungese transparence dhe informimi shoqërive pjesëmarrëse u është mohuar e drejta për të paraqitur ankesat apo pretendimet e tyre lidhur me mos kualifikimin e tyre apo lidhur me vlerësimin e ofertave të tyre.

Së dyti, në procedurën në fjalë nuk janë përcaktuar se kush janë kriteret mbi bazën e të cilave është bërë vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit.

Nëse i referohemi njoftimit “Ftesë për shprehje interesit” të Albpetrol sh.a dhe rregullores “*Për Procedurat e Miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse*” vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit do të bëhej sipas një sistemi pikëzimi bazuar në kapacitetet teknike dhe financiare dhe kushtet që do propozonte secila prej shoqërive aplikuese për marrëveshjet hidrokarbure për secilin vendburim.

Në formularin standart të aplikimit në *seksionin B* përcaktohen kapacitetet teknike, në *seksionin C* kapacitetet financiare dhe në *seksionin D* kushtet e marrëveshjeve hidrokabure që propozonte secila prej shoqërive. Kualifikimi dhe vlerësimi i ofertave do të bëhej së pari duke verifikuar nëse shoqëritë plotësonin kapacitetet teknike dhe financiare të kërkuar dhe për ato shoqëri që i plotësonin zgjedha e fituesit, normalisht, duke qenë se nuk janë përcaktuar paraprakisht kriteret për shpalljen e fitues, do bëhej mbi bazën e kushteve më të favorshme që secila prej tyre kishte propozuar.

Ky eshte dhe një qendrim i mbajtur në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj prej Gjykates se Drejtësisë e Bashkimit European (GJED).

Kështu, GJED ka vlerëuar se kriteret e dhënies së kontratës përbëjnë bazën mbi të cilën autoriteti kontraktues zgjedh ofertën më të mirë për një kontratë. Këto kriterë duhet të përcaktohen dhe t'i komunikohen ofertuesve të mundshëm paraprakisht nga autoriteti kontraktues. Kriteret e dhënies së kontratës nuk duhet të janë të dëmshme për konkurrencën e drejtë. Kriteret që mund të përdoren, janë ose i) çmimi më i ulët, ose ii) oferta ekonomikisht më e favorshme, për të cilat mund të zbatohen kriteret shtesë apo të tjera. GJED gjithashtu thekson se duhet të ketë rregulla të përgjithshme në lidhje me formulimin e kritereve specifike që mund të zbatohen kur përdoret kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme. Objektivi kryesor është të sigurojë që ushtrimi i tregtisë të mos kufizohet nga kriteret diskriminuese të dhënies së kontratës.

Kur vendosen dhe zbatohen kriteret e dhënies së kontratës, autoriteti kontraktues duhet të veprojë në përputhje me parimet e përgjithshme të prokurimit publik dhe në veçanti të sigurojë:

Trajtimi i barabartë dhe jo diskriminim: kriteret e dhënies së kontratës duhet të janë jo-diskriminuese dhe nuk duhet të janë të dëmshme për konkurrencën e drejtë;

Transparenca: kriteret e dhënies së kontratës duhet të vendosen paraprakisht dhe t'i bëhen të ditura ofertuesve për të siguruar që:

- ofertuesit i përgatisin ofertat e tyre me qëllim që të përbushin sa më mirë priorititetet e përcaktuara nga autoriteti kontraktues;
- vlerësimi i ofertave të kryhet nga autoriteti kontraktues në mënyrë transparente dhe të besueshme dhe sa më objektive;
- palët e interesuara, siç janë organet e kontrollit, organet e shqyrtimit të ankesave, organet e tjera qeveritare ose operatorët ekonomikë, të monitorojnë procesin në mënyrë që të parandalojnë përdorimin e kritereve diskriminuese ose të paautorizuara të dhënies së kontratës.

Përgjedhja ndërmjet kriterit më të ulët të çmimeve dhe të kriterit të ofertës ekonomikisht më të favorshme është lënë në përgjithësi në gjykimin e autoritetit kontraktues. Për procedurën e dialogut konkurrues apo një procedurë në të cilën autoriteti kontraktues pranon variante, duhet të përdoret kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme. Autoriteti kontraktues duhet të tregojë në njoftimin e kontratës nëse ai do ta zbatojë apo jo kriterin e cmimit më të ulët ose kriterin e ofertës ekonomikisht më të favorshme.

GjED-ja ka bërë të qartë në jurisprudencën e saj se përgjedhja e operatorëve ekonomikë dhe dhënia e kontratës përfaqësojnë dy fazë të ndryshme të procesit të prokurimit, me qëllim të dallueshme. Në çdo fazë zbatohen kriteret të ndryshme.

Në çështjen C-532/06 *Lianakis* dhe të tjerë, GjED-ja konfirmoi se kriteret e përdorura në fazën e përgjedhjes janë të lidhura me vlerësimin e aftësive të ofertuesit për të zbatuar kontratën. Kriteret e përdorura në fazën e shpalljes së ofertës fituese kishin për qëllim të identifikonin ofertën më të mirë. Pra, në ato raste kur autoriteti nuk ka paracaktuar saktë kriteret e shpalljes së ofertës fituese, si kriteret do të merret ai i ofertës më të mirë apo më të favorshme.<sup>1</sup>

Vleresohet prej gjykates se nga ana e Ministrisë dhe Albpetrol nuk është bërë një vlerësim i tillë dhe një krahasim i ofertave dhe më pas të jepeshin arsyet e përgjedhjes së fituesit. Kjo e bën të dyshimtë gjithë procedurën e ndjekur për vlerësimin e ofertave dhe përcaktimin e fituesit.

Së terti, shoqëria Transoil Group AG (sot shoqëria Terra Oil Swiss) është përgjedhur fituese edhe pse kushtet e marrëveshjeve hidrokarbure të propozuara prej saj janë më pak të favorshme se ato të propozuara nga shoqëria Letho Resources Corp.

Rezulton se grupi i punës i Albpetrol sh.a ka kualifikuar 3 nga 7 shoqëritë pjesëmarrëse, sipas të cilës, plotësonin kapacitetet teknike dhe financiare: shoqerinë Transoil Group AG, Bankers Petroleum dhe Letho Resources Corp.

Ministri ka filluar procedurat per te përgjedhur si fituese shoqërinë (ish- Transoil Group sh.a) aktualisht " TerraOil Swiss" sh.a, por pa dhënë asnjë arsyë mbi mënyrën e vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave të tyre. Siç u tha më sipër, meqënëse këto 3 shoqëri plotësonin kapacitetet teknike dhe financiare, vlerësimi i ofertave të tyre do bëhej mbi bazën e kushteve bazë të marrëveshjeve hidrokarbure që kishte propozuar secila prej tyre. Normalisht, ajo shoqëri që kishte propozuar kushtet më të favorshme do të përzgjidhej si fituese.

<sup>1</sup> Çështja C-532/06 *Emm. G. Lianakis AE* dhe të tjerët kundër *Dimos Alexandroupolis* dbe të tjerët

Referuar akteve te paraqitura nga palet ne dobi te ketij gjykimi konstatohet se nuk eshte ndiekur nje procedure e tille per shpalljen e fituesit dhe konkretisht per vendburimin Cakran-Mollaj.

Duke j'u referuar kushteve që secila prej këtyre kompanive ka propozuar në seksionin D të Formularit Standard të Aplikimit,nga një krahasim i thjesht rezulton se:

Për vendburimin **Cakran Mollaj**, oferta e shoqërisë Letho Resources Corp., ka qenë më e mirë në të gjitha aspektet. Kjo shoqëri propozon një investim për këtë vendburim prej 4.6 milion USD, ndérkohë shoqëria ( ish- Transoil Group sh.a) aktualisht "Terraoil Swiss" sh.a 3 milion USD (seksioni D, pika b.i). Produkti paraprodhimit, shoqëria Letho 71%, ndërsa ( ish- Transoil Group sh.a) aktualisht "Terraoil Swiss" sh.a 70% (seksioni D, pika c.ii). Kostot e rikuperueshme nga shoqëria Letho janë 89.5%, ndërsa nga shoqëria ( ish- Transoil Group sh.a) aktualisht "Terraoil Swiss" sh.a 90% (seksioni D, pika c.iii dhe c.iv. Bonuset për punonjësit nga Letho janë 85.000 USD, ndërsa nga ( ish- Transoil Group sh.a) aktualisht "Terraoil Swiss" sh.a 50.000 USD. Po ashtu bonusi i prodhimit për Albpetrol është më i lartë ai i shoqërisë Letho krahasuar me sasinë e produktit të prodhuar.

Në mënyrë më të qartë krahasimi i ofertave pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Transoil	Letho	Diferencia	Shënime
1	Periudha e Vlerësimit	24 Muaj	24 Muaj	0	Nuk ka diferençë.
2	Vlera e Investimit gjatë periudhës së Vlerësimit (USD)	3.000.000	4.600.000	1.600.000	Oferta e "Letho", e cila është 1.6 milion Usd më e lartë se oferta e "Transoil", konsiderohet si oferta më e mirë.
3	Periudha Prodhimit	25+5 Vjet	25+5 Vjet	0	Nuk ka diferençë
4	Pjesa Prodhimit të Palës Shqiptare PPPS	$R < 1 = 1\%$	Nga 1.5%-4%	0.5-3%	Oferta e "Letho", e cila është minimalisht 0.5% dhe maksimalisht 3% më e lartë se oferta e "Transoil", konsiderohet si ofertë me e mirë. Nëse do të llogarisim që prodhimi i kësaj fushe gjatë kontratës do të jetë 1.000.000 Ton, atëherë, bazuar në parashikimet e çmimit të Brent, oferta e "Letho", krahasuar me oferten e "Transoil" është nga 1.500.000 USD deri në 9 milion USD më e mirë.

5	Prodhimi Para Ekzistues	70%	71%	1%	Oferta e "Letho", e cila është 1% më e lartë se oferta e "Transoil", 71% kundrejt 70%, konsiderohet si oferte më e mirë. Nëse do të konvertohej në kesh kjo diferencë kap vlerën e mbi 350.000 USD.
6	Koeficenti i Rënies Eksponencial	10%	10%	0	Nuk ka diferenca
7	Tavani i Mbulimit të kostove hidrokarbure	90%	89.5%	0.5%	Përqindja duhet të jetë sa më e ulët. Kjo do të thotë që më pak shpenzime futen në Llogarinë Kosto, pra kontrata do të rezultojë fitimprurëse më parë dhe me sasi më të lartë dhe do të përkthehet në më tepër tatim fitimi për palen e shtetit shqiptar. Për këtë arsyе oferta e "Letho", e cila është 0.5% më e mirë se oferta e "Transoil", konsiderohet si ofertë më e mirë.
8	Tavani i Naftes së disponueshme për të mbuluar kostot hidrokarbure	90%	89.5%	0.5%	Përqindja duhet të jetë sa më e ulët. Kjo do të thote që 10 % (100%-90%) e naftes së prodhuar në rastin e ofertës së "Transoil", ose 10.5% (100%-89.5%) në rastin e ofertës së "Letho" ndahet menjëherë në masën 50/50% me shtetin shqiptar. Pra, shteti shqiptar në rastin e ofertës "Transoil", perveç te tjerave merr në pronësi 5% të Naftes së Prodhuar, ndërkohë që në rastin e ofertës "Letho" merr në pronësi perveç te tjerave edhe 5.25% të Naftes së Prodhuar. Për këtë arsyе oferta e Letho, e cila është 0.5% më e mirë se oferta e "Transoil", konsiderohet si ofertë më e mirë.

9	Vlera e Bonusit të Nënshkrimit (USD)	30.000	60.000	30.000	Oferta e "Letho" është 30.000 USD më e larte krahasuar me ofertën e "Transoil Group".
10	Vlera e Bonusit të Trajnimit (USD)	20.000	25.000	5.000	Vlera e Bonusit të trajnimit paguhet çdo vit. Për këtë arsy, oferta e "Letho" është 5.000 USD X 32 Vite (24 Muaj +25 vjet +5 vjet) = 160.000 USD më e mirë krahasuar më ofertën e "Transoil Group".
11	Vlera e Bonusit të Prodhimit (USD)				Vlera e propozuar nga Letho është më e lartë se ajo e Transoil.

Si konkluzion, nga 11 zëra që ka oferta drejtuar shoqërisë "Albpetrol"sha, për vendburimin "Cakran-Mollaj", oferta e shoqërisë "Letho Resources Corp" është më e mirë në 8 zëra, dhe e njëjtë në 3 zëra. Pra, oferta e shoqërisë "(ish- Transoil Group sh.a) aktualisht " Terraoil Swiss" sh.a në asnje zë nuk është superiore kundrejt ofertës së "Letho Resources Corp". Në vlerë monetare oferta e "Letho", për palën e shtetit shqiptar është rrëth 10 milion dollarë më e mirë krahasuar me ofertën e shoqërisë (ish- Transoil Group sh.a) aktualisht " Terraoil Swiss" sh.a . Duke pasur parasysh, kohëzgjatjen e marrëveshjeve hidrokarbure 25 +5 vjet, rezulton se oferta e shoqërisë "Letho Resources Corp" do të sillte një përfitim për shtetin shqiptar prej 250-300 milion dollarë më shumë se ajo e "Transoil Group AG".

Si konkluzion, referuar tabelave te mesiperçituara, vleresohet se nga MIE, si oferta më e mirë nuk duhej të ishte shpallur ajo e shoqërisë (ish- Transoil Group sh.a) aktualisht " Terraoil Swiss" sh.a por ajo e shoqërisë "Letho Resources Corp".

Së katërti, pala padite se kete gjykim pati një nga pretendimet e saj kryesore se aplikimi i shoqërisë (ish- Transoil Group sh.a) aktualisht " Terraoil Swiss" sh.a nuk duhet të ishte marrë fare në shqyrim pasi kjo shoqëri nuk ka paguar tarifën për paketën e të dhënavë për secilin vendburim në momentin e aplikimit.

Njoftimin "Ftesë për shprehje interesit", shoqëria Albpetrol sh.a përcaktonte qartë se çdo operator i interesuar për të aplikuar për vendburimet respektive, fillimisht duhet të blinte Paketën e të Dhënavë teknike (në vlerën 6.500 USD për secilin vendburim) dhe vetëm pas konfirmimit të kryerjes së pagesës, operatori mund të dorëzonte ofertën e tij.

Po ashtu, referuar njoftimit të Albpetrol sh.a, të gjitha aplikimet duhet të dorëzoheshin zyrtarisht në Albpetrol jo më vonë se më 31 mars 2018, ora 15.00 (ora lokale). Asnjë kërkesë nuk do të pranohet pas afatit përfundimtar të përcaktuar këtu.

Kjo do të thotë që secila nga shoqëritë aplikuese, duhet të kishte kryer pagesën brenda datës 31 mars 2018 në mënyrë që të pranohej aplikimi i saj.

Pala paditese pretendoi se Shoqëria ( ish- Transoil Group sh.a) aktualisht " Terraoil Swiss" sh.a rezulton se e ka kryer pagesën për të 3 vendburimet, më datë 4 prill 2018, pra 4 ditë pas afatit të fundit të dorëzimit të aplikimit. Për rrjedhojë, aplikimi kësaj shoqërie nuk duhet të ishte pranuar nga Albpetrol sh.a, ashtu siç nuk është pranuar aplikimi i dy shoqërive të tjera që nuk kishin kryer pagesën.

Lidhur me këtë moment, gjatë gjykimit përfaqësuesi i Albpetrol sha prapësoi se pagesa është kryer, por pa paraqitur ndonje prove konkrete ne lidhje me kete pretendim, duke j'u referuar vetem një shkresë me lende : Kthim pergjiogje me nr.3091/2.Prot.date 10.04.2018 ku drejtuesja e finances e Shoqise "Albpetrol" znj. Zh.Ndreko i kthenete pergjiogje kryetarit te grupit te punes ne pergjiogje te shkreses se tij me nr.3091/1.Prot.date 06.04.2018 ( v.o.gabimisht eshte bgere data e vitit 2014) se per terheqjen e paketave përvendburimet janë kryer, ku rezulton se janë kryer edhe nga personi i trete ne kete gjykim

Gjykata, nisur nga fakti qe ne kete shkresë nuk jepej arsyja se perse kjo shkresë i eshte drejtuar kryetarit te grupit te punes z.Bardhi Leke pikerisht me date 10.04.2018 dhe jo me date 31.03.2018 ora 15.00 dita dhe ora kur mbaronte afati i aplikimit nga shoqëri pjesmerrese, i kekoi pales se paditur Albpetrol sha ne konformitet me nenin 36 te ligjit me nr.49/2012 "Per gjykatat administrative..." qe ne seancen e dates 20.05.2019 qe ajo ne seancen pasardhese te provonte me ane te provave shkresore qe kjo shoqeri "Terraoil Swiss" sh.a i kish kryer pagesat per terheqjen e ketyre paketave perpara dates 31.03.2018, por kjo pale nuk i paraqiti keto prova ne seancen pasuese ku dhe nuk miori pjese, por vetem ne ate seance kish derguar prapesimet e saj pa u shkprehur per kete prove te kerkuar nga ana e gjykates, por kerkoi ne seancen e dates 24.06.2019 qe ishte lene qe palet te parashtronin pretendimet e tryre perfundimtare me shkrim, qe te riçeleje hetimi gjyqesor me qellim qe ajo te paraqeste si prove faktin e provueshmerise se pageses pikerisht me date 31.03.2019, pretendim i cili nuk u pranua nga ana e gjykates me argumentat e dhena ne fillim te çeljes se kesaj seance per kete kerkese, pasi nuk ndodheshim ne kushtet e parashikuara ne nenin 151 dhe 186 te K.pr.Civile.

Vlen per t'i theksuar se pala paditese pretendoi gjate gjykimit se ne kushtet e provueshmerise se pretendimit te saj se shoqeria "Albpetrol" sh.a i ka paraqitur kryerjen e pagesave te paketes pas dates 31.03.2018 ora 15.00, theksoi se ne : *kemi një kopje të ekstraktit bankar të shqërisë Albpetrol sh.a ku pasqyrohet qarti ky fakt, pra pagesa në datën 04.04.2018, por nga ana e gjykates, nuk u mor ne shqyrtim gjyqesor nje prove e tille, perderisa ajo nuk ishte nje prove e cila te sherbente si e tille ne kuptim te nenit 11 te K.Pr.Civile, pasi nuk ishte e orgjinale apo e noterizuar. Pra ky pretendim i pales paditese ngeli i pa provuar dhe per rrjedhoje nuk mund te merret parasysh nga gjykata. Pra gjykata nuk mundte te arrije ne konkluzionin se shoqeri " Terraoil Swiss" sh.a duhej te konsiderohej automatikisht e skualifikuar vetem per kete fakt, pra te moskryerjes se pageses per Paketen e të Dhënave teknike (në vlerën 6.500 USD për secilin vendburim), por ia neneshtroi hetimin gjyqesor te kesaj çeshtje ne kushtete e kerkimit te pales paditese proceduren dhe paligjshmerine e veprimeve te kryera ne kete procedure tenderizimi.*

Së pesti, nga provat e administruara rezulton se shoqëria ( ish- Transoil Group sh.a) aktualisht " Terraoil Swiss" sh.a nuk ka qene ne plotësim te kapaciteteve teknike për t'u kualifikuar si me e mira dhe nuk rezultoi e provuar qe ne proceduren e vleresimit te kete paraqitur ndonje dokumentacion për të justifikuar këto kapacitetet.

Nëse i referohemi procesverbalit të datës 11.04.2018 të mbajtur nga grupei i punës i Albpetrol sh.a, Formularëve Standard dhe dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria shoqëria ( ish- Transoil Group sh.a) aktualisht " Terraoil Swiss" sh.a rezulton se kjo shoqëri ka aplikuar për të trija vendburimet dhe dokumentacioni i paraqitur përbëhet nga:

1. Formularët e Aplikimit;
2. Bilancin e tri viteve të fundit;
3. Raportet tremujore të dy viteve të fundit
4. Listën e personelit inxhiniero-teknik.

Ndërkohë, dokumentacioni që kërkohej sipas Formularëve Standard të Aplikimit ishte si vijon:

1. Bilancin e tri viteve të fundit;
2. Raportet financiare gjatë tri viteve të fundit;
3. Pasqyrë e konsoliduar e fitimit dhe humbjes
4. Të dhënat për aftësitë financiare
5. Të dhëna për kapitalet e kredituara
6. Mënyra e financimit
7. Përshkrim i operacioneve të zhvillimit dhe prodhimit të hidrokabureve të kryera;
8. Përshkrim i operacioneve të zhvillimit dhe prodhimit të hidrokabureve të kryera në vende të ngashme;
9. Kapacitetet teknike të stafit që kanë kryer dhe drejtuar punimet e mëparshme të zhvillimit dhe prodhimit.
10. Të dhëna për operatorin e ngarkuar për menaxhimin teknik të punës.

Pra, konstatohet se Shoqëria shoqëria ( ish- Transoil Group sh.a) aktualisht ”**TerraOil Swiss**” sh.a nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provonte plotësimin e kapaciteteve teknike të saj dhe ato të paraqitura për justifikimin e kapaciteteve financiare janë të mangëta.

**Pra,kjo eshte një nga arsyet qe kjo shoqeri nuk mundte te kualifikohej si prioritare kundrejt pales paditese dhe per me teper ne mungese te plotesimit te ketij kushti ajo duhej te s'kualifikohej per kete vendburim.**

Kërkimi i dytë i objektit të padisë është njojja e shoqërisë “Letho Resources Corp.” si fituese dhe dhënien e së drejtës për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin ekzistuese “Cakran-Mollaj”. Ky kërkim, nuk ka si shkak ligjor detyrimin e MIE për të lidhur marrëveshjen hidrokarbure me shoqërinë “**Letho Resources Corp.**” por njojhen kësaj shoqërie si fitues, pasi ka dhënë ofertën me të mirë dhe dhënien e së drejtës asaj për të negociuar për lidhjen e marrëveshjes hidrokarbure. Pra, në thelb të kërkimit nuk është detyrimi për të lidhur marrëveshje, por njojja e një të drejtë për të hyrë në negociata për marrëveshje. Në çdo rast, do të jetë në vullnetin e MIE që të filloj ose jo negociatat me këtë shoqëri.

Po ashtu, ky kërkim, ndrysh nga sa pretendojnë palët e paditur dhe personi i tretë gjen mbështetje në ligjin nr.45/2012, i cili parashikon qartë se padia ngrihet, ndër të tjera: a) për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ; b) për ndryshimin, pjesërisht apo tërësisht, të aktit administrativ apo detyrimin e organit publik për të ndryshuar një akt administrativ; c) për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ; ç) për të detyruar organin publik të kryejë një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë; d) për konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ, që nuk prodhon pasoja juridike, nëse paditësi ka një interes të arsyeshëm për këtë; dh) për saktësimin e të drejtave dhe të detyrimeve ndërmjet paditësit dhe organit publik; e) për detyrimin e organit publik për të kryer apo për të ndaluar kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, të nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave apo të interesave të paditësit.

Si konkluzion, përzgjedhja e shoqërisë shoqëria (ish- Transoil Group sh.a) aktualisht "Terraoil Swiss" sh.a si oferta më e mirë pa dhënë arsyen mbi mënyrën e vlerësimit dhe krasimit të ofertave dhe duke qenë evidente se oferta e saj ishte më pak e favorshme në krasim me palen padite se shoqërinë Letho Resources Corp., shtuar këtu edhe mungesën e transparencës, informimit dhe shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve, tregojnë qartë se shoqëria shoqëria (ish- Transoil Group sh.a) aktualisht "Terraoil Swiss" sh.a është favorizuar kundrejt pales padite se ka qene favorizuuese per kete vendurim Cakran-Mollaj.

Cmohet se oferta e paraqitur nga shoqëria Letho Resources ka qenë oferta më e mirë, për rrjedhojë duhet të ishte kjo e fundit fituesja e procedurës dhe shoqëria së cilës duhet t'i jepej e drejta për të hyrë në negociata për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimin "Cakran-Mollaj".

Në këto kushte, duke çmuar se dhënia e së drejtës shoqërisë shoqëria (ish- Transoil Group sh.a) aktualisht "Terraoil Swiss" sh.a për negocimin për lidhjen e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin "Cakran-Mollaj" është bërë në kundërshtim me Rregulloren "Për Procedurat e Miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjeve, si dhe afatet përkate" dhe K.Pr.Administrative, procedurat e mëtejshme për negocimin dhe lidhjen e kësaj marrëveshjeje me këtë shoqëri duhen anuluar si të paligjshme duke njojur si fituese shoqërinë "Letho Resources Corp.", si ofertuesja më e mirë, dhe duke i dhënë asaj të drejtën për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për këto vendburime.

Dukeqenese ne objektin e kerkimit te pales padite se ka qene si pike e trete e objektit padise edhe : Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar procedurat për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimin ekzistues "Cakran-Mollaj" me shoqërinë (ish- Transoil Group sh.a) aktualisht "Terraoil Swiss" sh.a, kerkese e cila eshte marre ne shqyrtim nga ana e eksaj gjykate brenda afatit ligjor 5 ditor nga paarqitja e eksaj padie dhe per te cilen gjykata ka dale me vendimin e saj date 15.04.2019 ku ka vendosur : *Pranimin e kërkesës në lidhje me pikën e tretë të objekti te këtij gjykimi.*

-Marrjen e masës së sigurimit te padise , duke urdhëruar: Pezullimin e procedurave për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimin ekzistues "Cakran-Mollaj" me shoqërinë "Transoil Group" sh.a, nisur nga fakti se gjykata krijo bindjen se kjo padie eshte e bazuar ne prova dhe ne ligj dhe duhet pranuar, atehere gjykata ne konformitet me nenin 212 te K.Pr./Civile ku citohet se : Neni 212/Ligjërimi i masës së sigurimit të padisë

"Kur në vendimin përfundimtar padia **pranohet**, gjykata **vendos edhe ligjërimin e sigurimit të padisë**. Kur si masë sigurimi të padisë është vendosur sekuestrimi, ajo kthehet në sekuestrim ekzekutiv, pasi vendimi përfundimtar të marrëformën e prerë "

Gjykata vendosi: Ligjerimin e mases se sigurimit te kesaj padie te marre ne vendimin e dates 15.04.2019. Perfundimisht, gjykata arriti ne konkludimin se kjo padi eshte bezuar ne prova dhe ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

Persa me siper u provua me ane te parashtrimet e paraqitura ne kete gjykim dhe me provat qe u paraqiten.

Ne mbeshtetje te nenit 106 te K.Pr.Civile, duke qene se kjo padi u pranua prej Gjykates, atehere taksa mbi aktet, shpenzimet e tjera gjyquesore dhe per nje avokat i ngarkohen pales se paditur.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata,bazuar ne nenin 126 dhe 310 te K.Pr.Civile dhe nenet 40, 42 te ligjit me nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative".

**VENDOSI :**

- Pranimin e padise.
- Anullimin e procedurave për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimin ekzistues "Cakran-Mollaj" me shoqërinë (ish-TransoilGroup) "TerraOil Swiss" sh.a.
- Njohjen e shoqërisë "Letho Resources Corp" si fituese dhe dhënien e së drejtës për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjes hidrokarbure vendburimin ekzistuese "Cakran-Mollaj".
- Ligjerimin e mases se sigurimit te padise te marre nga ana e kesaj gjykate per kete çeshtje me date 15.04.2019.
- Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen pales se paditur.
- Ky vendim perben titull ekzekutiv dhe eshte i ekzekutueshem nga permbarimi gjyqesor dhe duhet te ekzekutohet prej pales se paditur brenda 10 diteve nga marrja e ketij vendimi forme te prre.
- Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykaten Administrative te Apelit Tirane, brenda 15 diteve, afat i cili per palet nis nga e nesermja e marrjes dijeni mbi vendimin e arsyetuar te kesaj gjykate (*vendim i cili u shpall i arsyetuar*).

U shpall, në Vlore, sot më date 27.06.2019

**S E K R E T A R E**

Anila Rista

**G J Y Q T A R I**

Astrit Shema

**SHPENZIMET GJYQESORE**

Takse padie 3.000 leke

Takse njoftimi 240 leke

Shuma totale 3.240 leke

08 JUL 2013

INDONESIA/5

15-07-2013

15-07-2013

15-07-2013